FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 33	2000	Tetor

P Ë R M B A J T J A

Dekret nr.2766 datë 20.10.2000	Për lënie të shtetësisë shqiptare	1613
Vendim i KM nr.556, datë 23.10.2000	Për dorëzimin e dokumentacionit të pronësisë, në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme	1614
Vendim i KM nr.557, datë 23.10.2000	Për disa ndryshime në vendimin nr.43, datë 21.2.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për mbulimin e vlerës së mallrave të shoqërive huamarrëse, të vjedhura e të grabitura në depot e drejtorisë së përgjithshme të rezervave shtetërore"	1615
Vendim i KM nr.559, datë 23.10.2000	Për një ndryshim të vendimit nr.213,datë 28.3.1998, të Këshillit të Ministrave,"Për rritjen e pagave të funksioneve të larta shtetërore"	1615
Vendim i KM nr.560, datë 23.10.2000	Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e spitalit të Durrësit në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor	1616
Vendim i KM nr.562, datë 23.10.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.479, datë 31.8.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për përgatitjen dhe	

	realizimin e kontratës së koncesionit, për ndërtimin e terminalit të ri të pasagjerëve, në Aeroportin e Rinasit"	1620
Vendim i KM nr.564, datë 23.10.2000	Për disa ndryshime në vendimin nr.743, datë 18.12.1995, të Këshillit të Ministrave, "Për rritjen e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për përdoruesit jofamiljarë"	1621
Vendim i KM nr.568, datë 23.10.2000	Për kalimin në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të objekteve "Monument Kulture " në përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes"	1622
Vendim i KM nr.571, datë 23.10.2000	Për miratimin e Masterplanit të Menaxhimit të Trafikut Ajror Shqiptar	1623
Vendim i KM nr.572, datë 26.10.2000	Për një shtesë në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2000, për përballimin e kostos së punimeve, për zgjerimin e rrugës Llogara-Palasë	1624
Vendim i Gj.K nr.69 datë 16.10.2000	Me objekt: Shfuqizimin si antikushtetues i vendimeve nr.2784, datë 10.06.1997 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.1762, datë 20.08.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 742, datë 04.06.1998 të kolegjit civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.756, datë 12.05.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë	1624
Vendim i Gj.L nr.284	Me objekt: Kthim shume dhe shpërblim dëmi	1627
Vendim i Gj.L nr.979	Me objekt: Kërkimin e trashëgimit, në bazë të nenit 350 të Kodit Civil	1633
Vendim i Gj.L nr.980	Me objekt: Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv bazuar në nenin 609 të Kodit të Procedurës Civile	1638
Udhëzim nr.1 datë 5.10.2000	Për kriteret teknike të përllogaritjes së vlerës së bimëve drufrutore që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes	1642

D E K R E T
Nr.2766, datë 20.10.2000

PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E TO J:

Neni 1

U hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Llesh Pal Gjinaj
2. Alush Muhamet Thaçi
3. Artur Agim Metani
4. Bilal Ymer Ymeri
5. Pëllumb Esat Selimi
6. Irfan Rifat Torozi
7. Rinato Irfan Torozi
8. Sulltane Hysen Torozi (Zorba)
9. Jeton Irfan Torozi
10. Suata Irfan Torozi
11. Anisa Irfan Torozi
12. Mihal Llazar Topulli
13. Klaured (Klaored) Mihal Topulli
14. Xhemile Haxhi Topulli
15. Adhurim Sehit Azizi
16. Brian Adhurim Azizi
17. Sergio Adhurim Azizi
18. Myzejen Ismail Joosten (Zari)
19. Skënder Kamber Hoxha
20. Izmir Zenun Ndreu
21. Rolan Nazmi Ymet (Riedesel)
22. Luljeta Koço Papaproko-Brünjes
23. Almir Rait Kasembej (Daja)
24. Mario Almir Kasembej
25. Alda Almir Kasembej
26. Daniela Hariz Kasembej (Daja)
27. Klevis Piro Laçka
28. Petrit Xhemal Përmeti
29. Rafet Gjolek Hatellari
30. Arben Hamit Çela
31. Marcel Arben Çela
32. Dennis Arben Çela
33. Luljeta Xhemal Çela (Tafa)
34. Fatos Riza Katia
35. Edit Fatos Katia.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr.556, datë 23.10.2000

PËR DORËZIMIN E DOKUMENTACIONIT TË PRONËSISË, NË ZYRAT E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 56 dhe 57, të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe i Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D OS I:

1. Seksionet e kadastrës, zyrat e agjencive kombëtare të privatizimeve, komisioni i kthimimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve, Enti Kombëtar i Banesave në rrethe, si dhe institucionet e tjera, që lëshojnë dokumente pronësie, detyrohen t'i dorëzojnë këto dokumente në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të rrethit përkatës.

2. Marrja në dorëzim e dokumenteve të pronësisë, bëhet në bazë të një procesverbali dorëzimi, që nënshkruhet nga regjistruesi i zyrës së regjistrimit dhe titullari i institucionit që ka lëshuar dokumentet.

3. Për dokumentet e pronësisë, të lëshuara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, afati maksimal i dorëzimit të tyre është 31.12.2000. Çdo dokument pronësie që lëshohet pas kësaj date, duhet të dorëzohet pranë zyrave të regjistrimit, brenda dy muajve nga data e lëshimit të tij.

4. Institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, përpara marrjes së vendimit përkatës për njohjen ose për kthimin në natyrë të pronësisë, duhet të marrin nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të dhënat e nevojshme gjeografike dhe hartën e tyre treguese. Çdo dokument pronësie, i lëshuar në kundërshtim me këtë pikë të këtij vendimi, nuk ka vlera regjistruese.

5. Ngarkohen Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe ministritë e institucionet që kanë të bëjnë me njohjen, regjistrimin dhe administrimin e të drejtave të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.557, datë 23.10.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.43, DATË 21.2.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MBULIMIN E VLERËS SË MALLRAVE TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE, TË VJEDHURA E TË GRABITURA NË DEPOT E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE SHTETËRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 27, të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 7, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit për vitin 2000", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.43, datë 21.1.1999, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

- Pika 2 ndryshohet si vijon:

"2.Fondi në vlerë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të mbulohet nga gjendja në valutë e llogarisë likujduese të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Shtetërore, pranë Bankës Kombëtare Tregtare, me emërtimin "Fond kundërparti për kompensim dhe blerje", gjendja e së cilës, pas kryerjes së veprimit si më sipër, derdhet e tëra në buxhetin e shtetit.".

- Pika 3 ndryshohet si vijon:

"3. Ngarkohet Ministria e Financave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 559, datë 23.10.2000

PËR NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR.213, DATË 28.3.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR RRITJEN E PAGAVE TË FUNKSIONEVE TË LARTA SHTETËRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999, "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe i Çështjeve Sociale", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 213, datë 28.3.1998, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në lidhjen I "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit", në shkronjën "B3" shtohet emërtimi "Drejtor drejtorie në ministri" dhe shfuqizohet ky emërtim në shkronjën "B4".

b) Në lidhjen II-5 "Niveli i pagës për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore", në numrin rendor 5 shtohet emërtimi "Drejtor drejtorie në ministri" sipas klasifikimit "B3" dhe shfuqizohet ky emërtim në numrin rendor 7.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi fillojnë nga data 1.10.2000 dhe do të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2000, për secilën ministri.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 560, datë 23.10.2000

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT PËR PËRFSHIRJEN E SPITALIT TË DURRËSIT NË SKEMIËN E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24 dhe 36 të ligjit nr. 7870, datë 13.4.1994, "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e projektit pilot për përfshirjen e spitalit të Durrësit në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor.

2. Miratimin e statutit të spitalit të Durrësit, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në kuadër të këtij projekti:

- Mbulimi i shpenzimeve të spitalit të Durrësit, me përjashtim të investimeve, të bëhet nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, duke filluar nga data 1.1.2001.
- Spitali i Durrësit funksionon si institucion shtetëror, jobuxhetor. Spitali do të organizohet dhe do të funksionojë në bazë të statutit.
- Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratë me spitalin e Durrësit, ku përcaktohen mënyrat e mbajtjes të së dhënave, llogaritja e shpenzimeve, procedurat e paraqitjes së tyre, pagesat dhe rimbursimet, sipas mënyrave të miratuara nga të dyja palët, të drejtat dhe detyrimet e palëve.
- Ministrisë së Shëndetësisë i pakësohen 684 punonjës si dhe buxheti përkatës, sipas zërave, duke përjashtuar zërin "Investime", i pakësohen 70 900 000 (shtatëdhjetë milionë e nëntëqind mijë) lekë.
- Numrit të punonjësve të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, të miratuar për vitin 2000, i shtohen 684 punonjës, si dhe kontributi i shtetit për ISKSH-në rritet në masën 70 900 000 lekë.
- Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, për të përballuar disbalancimet e buxhetit gjatë vitit, të përdorë fondin rezervë. Pjesa e fondit rezervë, që do të përdoret për këtë qëllim, miratohet nga Këshilli Administrativ i këtij instituti, por pa prekur shumën e financimit të veprimtarisë 3-mujore të tij.
- Shpërblimi i punonjësve të bëhet sipas sistemit të sotëm të pagave të punonjësve të institucioneve buxhetore. Me nxjerrjen e rezultatit financiar, spitali ka të drejtën t'i propozojë Këshillit Administrativ të ISKSH-së ndryshime në sistemin e pagave.
- Normativat e përdorimit të materialeve, të lëndëve djegëse, të ushqimit, normativat e ngarkesës së personelit mjekësor dhe të punonjësve të tjerë, sipas specialitetit, hartohen nga spitali i Durrësit dhe miratohen nga Këshilli Administrativ i ISKSH-së.
- Spitali i Durrësit zbaton tarifat për shërbimet me pagesë, të përcaktuara me vendimin nr.527, datë 1.11.1993, të Këshillit të Ministrave dhe në aktet nënligjore, të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë. Të ardhurat dytësore, të realizuara nga spitali i Durrësit, përdoren nga drejtoria e spitalit, sipas kritereve që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Spitali i Durrësit mund të organizojë shërbim special hotelerie në mjedise të veçanta, brenda spitalit. Pacientët, të cilët me dëshirë kërkojnë të trajtohen në këto mjedise paguajnë diferencën ndërmjet kostos faktike të trajtimit dhe kostos spitalore, të miratuar në buxhetin e vitit përkatës.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor ushtrojnë kontroll mbi veprimtarinë e spitalit Durrës, në mbështetje të rregullores së spitaleve dhe të statutit të miratuar.
- Bordi i spitaleve përgjigjet para Ministrisë së Shëndetësisë për veprimtarinë e spitalit.

- Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

STATUTI I SPITALIT DURRËS

Neni 1

Spitali Durrës, që më poshtë do të quhet Spitali, është institucion i shërbimit shëndetësor shtetëror me buxhet të pavarur, jo fitimprurës që të ushtron veprimtarinë e tij në bazë të Ligjit bazë të Shërbimit Shëndetësor, të Kushtetutës, në ambientin dhe me pajisjet që janë pronë e Ministrisë së Shëndetësisë.

Neni 2

SPITALI është person juridik me qendër në Durrës.

Neni 3

- Rregullorja e funksionimit teknik të Spitalit si institucion i shërbimit shëndetësor miratohet nga Ministria e Shëndetësisë.
- Rregullorja e funksionimit ekonomiko-financiar të Spitalit, hartohet dhe miratohet nga Bordi i Spitalit.
- Normativat e përdorimit të materialeve, lëndëve djegëse, të ushqimit, normativat e ngarkesës së personelit mjekësor dhe të punonjësve të tjerë sipas specialitetit hartohen nga Spitali i Durrësit dhe miratohen nga Këshilli Administrativ i ISKSH.

Neni 4

Spitali drejtohet nga:
- Bordi i spitalit
- Drejtori

Organi më i lartë ekzekutiv i Spitalit është Bordi. Bordi i Spitalit përbëhet nga 11 anëtarë. Përbërja e tij është si më poshtë:
- 1 përfaqësues i DSHP-së
- 1 përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë
- 1 përfaqësues i Bashkisë Durrës
- 1 përfaqësues i Spitalit Durrës (Drejtori)
- 2 përfaqësues i BOBSH
- 1 përfaqësues i ISKSH
- 1 përfaqësues i Urdhërit të Mjekut
- 1 përfaqësues i shoqatës së pacientëve
- 2 përfaqësues nga sindikatat më të përfaqësuara

Neni 5

Secila nga organizatat apo institutcionet e përmendura caktojnë përfaqësuesit e tyre në Bord. Periudha e përfaqësimit në Bord do të jetë 3 vjet.

Neni 6

Kryetari i Bordit është përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë.
N/Kryetari zgjidhet nga Bordi.

Neni 7

Mbledhja thirret nga Kryetari ose Nënkryetari në mungesë të Kryetarit. Drejtori i Spitalit ka të drejtë të kërkojë mbledhjen e Bordit kur gjykon se kërkohen vendime të shpejta që nuk janë në kompetencën e tij. Mbledhja e Bordit njoftohet me shkrim të paktën 7 ditë përpara duke bërë të ditur dhe rendin e ditës. Kur mbledhja thiret nga Drejtori, kriteri i afatit nuk zbatohet.

Neni 8

Mbledhja zhvillohet kur janë të pranishëm 2/3 e anëtarëve, në rast të kundërt mbledhja shtyhet për ditën tjetër duke bërë dhe njëherë lajmërimin. Në këtë rast mjafton gjysma e anëtarëve.

Për mbledhjen e Bordit mbahen procesverbal nga një person i pëhershëm i autorizuar nga Kryetari.

Vendimet e Bordit nënshkruhen nga Kryetari ose Nënkryetari dhe depozitohen në Spital.

Bordi mblidhet jo më pak se 4 herë në vit.

Neni 9

Vendimet e Bordit merren me shumicë votash. Çdo anëtar i Bordit ka të drejtën e një vote. Kur votat barazohen, vota e Kryetarit ose Nënkryetarit (në mungesë të kryetarit) është vendimtare.

Neni 10

Anëtarët e Bordit marrin një shpërblim për pjesëmarrje, masa e të cilit propozohet nga Spitali dhe miratohet nga Bordi.

Neni 11

Funksionet e Bordit janë:

- Të kontrollojë drejtimin e veprimtarisë së Spitalit
- Propozon në Ministrinë e Shëndetësisë për emërimin ose shkarkimin e Drejtorit, Nëndrejtorit të Spitalit
- Përgjigjet për zbatimin dhe kontrollin e politikave shëndetësore të Ministrisë së Shëndetësisë.
- Miraton projektin e kontratës që do të lidhet midis Spitalit dhe ISKSH.
- Miraton çdo vit raportin vjetor, bilancin, buxhetin vjetor dhe planin perspektiv 3 vjeçar të spitalit të paraqitur nga Drejtori i Spitalit.
- Pëërcakton dhe miraton strukturën dhe numrin e punonjësve të Spitalit dhe pagat. Miraton rregulloren e funksionimit ekonomiko-financiar (neni 3).
- Shqyrton noramtivat e përdorimit të materialeve, lëndëve djegëse, të ushqimit, normativat e ngarkesës së personelit mjekësor dhe të punonjësve të tjerë sipas specialitetit dhe i paraqet për miratim pranë ISKSH.
- Miraton përdorimin e tepricave në fund të vitit.
- Harton dhe miraton Rregulloren e funksionimit të Bordit.

Neni 12

Anëtarët e Bordit largohen nga detyra kur:

- dënohen për vepra penale.
- japin dorëheqjen.

Neni 13

Emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit të Spitalit bëhet nga bordi me miratim të Ministrit të Shëndetësisë.

Neni 14

Kompetencat e Drejtorit të Spitalit:

1. Drejtori i spitalit përfaqëson Spitalin si person jurudik. Ai është titullari ekzekutiv që drejton, organizon dhe ka të drejtë të ushtrojë kontrolle mbi veprimtarinë e Spitalit.
2. Raporton të paktën 1 herë në vit për veprimtarinë e Spitalit para Bordit.
3. Përcakton rregulloren e brendshme të Spitalit ose nxjerr urdhëra të brendshëm që rregullojnë veprimtarinë e Spitalit.
4. Ka të drejtë të punësojë personel mjekësor dhe jo mjekësor të Spitalit konform kërkesave të Spitalit.
5. Propozon në Bord buxhetin, paraqet raportin vjetor dhe bilancin financiar.
6. Merr mendime për largime nga puna për shkelje të kontratës, të rregulloreve të shërbimit apo të disipinës.
7. Përfaqëson Spitalin në bisedimet për lidhjen e kontratës midis këtij të fundit dhe DSKSH Durrës, kontratë kjo që përcakton Spitalin dhe DSKSH-në si palë.
8. Ndjek realizimin e treguesve tekniko-ekonomikë të Spitalit, vetë ose me zëvendësat e tij.
9. Nënshkruan të gjithë aktet dhe kontratat që angazhojnë Spitalin ndaj subjekteve ose personave të tjerë juridikë konform legjislacionit në fuqi. Miraton dokumentacionin dhe zbatimin e procedurave të prokurimit publik sipas ligjit në fuqi. Vlefshmëria ligjore e akteve, kontratave dhe procedurave të prokurimeve publike kontrollohen nga Kontrolli i Shtetit Durrës.
10. Përgjigjet para Bordit dhe Ministrisë së Shëndetësisë.
11. Vendos për kualifikimin dhe specializimin e kuadrit të lartë dhe të mesëm sipas nevojave dhe kërkesave të Spitalit.
12. Drejtori kur emërohet merr në dorëzim detyrën dhe kur largohen dorëzon detyrën me proces-verbal.

Neni 15

Në Spital funksionon Këshilli Teknik Administrativ me përbërje sipas rregullores së shërbimit të Kujdesit Shëndetësor dytësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 16

Problemet që nuk janë të përcaktuara në këtë statut, rregullohen me vendime të Bordit drejtues brenda dispozitave ligjore dhe kompetencave që i janë dhënë këtij Bordi.

V E N D I M
Nr.562, datë 23.10.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.479, DATË 31.8.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRGATITJEN DHE REALIZIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, PËR NDËRTIMIN E TERMINALIT TË RI TË PASAGJERËVE, NË AEROPORTIN E RINASIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr.7073, datë 26.7.1995, "Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", të neneve 21

dhe 29, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 7, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe të neneve 5 dhe 17, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe të ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.479, datë 31.8.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për përgatitjen dhe realizimin e kontratës së koncesionit, për ndërtimin e terminalit të ri të pasagjerëve, në Aeroportin e Rinasit”, pikat 5 dhe 6 shfuqizohen.

2. Pas pikës 4 të vendimit shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“Fondi prej 43 500 000 lekësh të përballohet nga fitimi i pritshëm për vitin 2000 i “Albtransport” sh.a.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.564, datë 23.10.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.743, DATË 18.12.1995, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE , “PËR RRITJEN E ÇMIMEVE TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PËRDORUESIT JOFAMILJARË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18, pika 4, të ligjit nr.7962, datë 13.7.1995, “Për energjinë elektrike” dhe të nenit 12, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.7970, datë 20.7.1995 “Për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Në vendimin nr.743, datë 18.12.1995, të Këshillit të Ministrave, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Çmimi i shitjes për përdoruesit jofamiljarë, të jetë sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi”

2. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për “Elektriku”, sh.a., Elbasan, “Elektriku Vlorë”, sh.a. dhe “Sesa Shkodër” sh.a. , të jetë 3 (tre) lekë për çdo kilovat/orë.

3. Ngarkohet KESH, sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

ÇMIMET E SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

DEGËT EKONOMIKE	Në fuqi	Propozohen
A. Përdoruesit familjarë	4	4

B. Sektorët kryesorë të ekonomisë	3	4.5
nafta, kromi, bakri, siderurgjia, gjeologjia,etj.	3	4.5
C. Subjektet e prodhimit të bukës	3	4.5
Ç. Subjektet e tjera prodhuese		
1.Furnizimi nga rrjeti TL(35 dhe 110 kV)	4.1	5.6
2.Furnizimi nga rrjeti TM(6,10 dhe 20 kV)		
a) matja në n/st	5.3	7
b) matja në primain e transformatorit		
c) matja në sekondarin e transformarit	5.4	7.3
3. Furnizimi nga rrjeti i TU	5.6	7.5
D. Subjekte të tjera të shërbimit, tregtimit, hotele, ente, zyra, etj.	6.3	8.5
I. Periudha Prill-Tetor		
1.Furnizimi nga rrjeti TL (35 dhe 110 kV)	0	0
2. Furnizimi nga rrjeti TM (6,10, 20kV)		
a) matja në n/st	5.1	6.5
b) matja në primarin e transformatorit	5.3	7
ç) matja në sekondarin e transformatorit	5.5	7.5
3. Furnizimi nga rrjeti i TU	6.3	8.5
II. Periudha Nëntor-Mars		
1.Furnizimi nga rrjeti i TL (35 dhe 110 kV)	0	0
2. Furnizimi nga rrjeti i TM(6,10 dhe 20 kV)		
a) matja në n/st	7.4	9
b) matja në primarin e transformatorit	7.7	9.2
ç) matja në sekondarin e transformatorit	8.1	9.6
3.Furnizimi nga rrjeti i TU	10.1	12
Filialet pilot	1	3

V E N D I M
Nr.568, datë 23.10.2000

PËR KALIMIN NË VARËSI TË MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE TË OBJEKTEVE "MONUMENT KULTURE" NË PËRDORIM TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të ligjit nr.7867, datë 12.10.1994, "Për mbojtjen e pasurisë kulturore, të luajtshme dhe të paluajtshme", me propozimin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të gjitha objektet e shpallura "Monument Kulture", që ndodhen brenda territorit të objekteve apo reparteve ushtarake, në çastin e shkrirjes, të transferimit apo të ndërprerjes së veprimtarisë së këtyre të fundit, kalojnë, menjëherë, në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Këto objekte përjashtohen nga procedura e përcaktuar me vendimin nr.153, datë 3.4.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin e objekteve e të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve e të institucioneve shtetërore".

3. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, t'i dorëzojë Ministrisë së Mbrojtjes listën e plotë të objekteve "Monument Kulture", të cilat ndodhen brenda zonave apo reparteve ushtarake.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Mbrojtjes, që, në zbatim të këtij vendimi, të nxjerrin aktet e nevojshme, për ruajtjen dhe administrimin e këtyre objekteve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.571, datë 23.10.2000

PËR MIRATIMIN E MASTERPLANIT TË MENAXHIMIT TË TRAFIKUT AJROR SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 41, të ligjit nr.7877, datë 30.11.1994, "Për aviacionin civil shqiptar", me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministave

V E N D O S I:

Miratimin e masterplanit të menaxhimit të trafikut ajror shqiptar, i cili do të realizohet me këshillimin e Organizatatës Europiane të Navigimit Ajror (EUROCONTROL), për një afat kohor 10-vjeçar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr. 572, datë 26.10.2000

PËR NJË SHTESË NË BUXHETIN E MINISTRISË SË MBROJTJES, PËR VITIN 2000, PËR PËRBALLIMIN E KOSTOS SË PUNIMEVE, PËR ZGJERIMIN E RRUGËS LLOGARA-PALASË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2000", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e vitit 2000, i shtohen 22 milionë lekë, nga të cilat 5 milionë për pagat e punonjësve civilë, 5 milionë lekë për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe 12 milionë lekë për shpenzime operative, për punimet për zgjerimin e rrugës Llogara-Palasë, të cilat do të kryhen nga brigada xhenjero-ndërtuese.

2. Ushtarakët dhe punonjësit civilë, për kohën që do të merren me kryerjen e punimeve, të përfitojnë:

- Oficer, nënoficer dhe punonjës civil deri në 300 për qind shtesë mbi pagën bazë.
- Ushtarakët aktiv deri në 10 000 lekë në muaj.
- Trajtimin me normën 6, të gjithë efektivave.

Në varësi të shkallës së vështirësisë, ministri i Mbrojtjes bën shkallëzimin e shtesave.

3. Efektet financiare, për përballimin e kostos së këtij projekti, të përballohen nga fondet e planifikuara në buxhetin e vitit 2000, për Ministrinë e Transportit.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i""
Zija Vuci,	Anëtar i""
Hajredin Fuga,	Anëtar i""
Alfred Karamuço,	Anëtar i""
Kristofor Peçi,	Anëtar i""
Sokol Sadushi,	Anëtar i""

me sekretare Drita Panda, më datat 18.09.2000 dhe 28.09.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.53 Akti që i përket:

KËRKUES: Shoqeria Anonime "Buka" Tiranë, e përfaqësuar nga avokat Agim Dishnica, me autorizim.

SUBJEKT I INTERESUAR: Shoqeria Imobiliare "Trema Engineering", e përfaqësuar nga avokat Kristaq Ngjela.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.2784, datë 10.06.1997 të Gjykatës së

Rrethit Tiranë; nr.1762, datë 20.08.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 742, datë 04.06.1998 të kolegjit civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.756, datë 12.05.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka paraqitur kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese duke parashtruar shkaqet e mëposhtme për shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të sipërcituara:

- Proceset gjyqësore të të gjitha shkallëve janë zhvilluar pa patur gjykata një përcaktim të qartë ligjor për palët, sepse ajo ka pranuar si paditës Shoqërinë "Trema Engineering", e cila nuk është palë në kontratë dhe aq më tepër që kjo kontratë është e paqënë, është letër e fotokopjuar, e pavulosur dhe e pavërtetuar;
- Është shkelur parimi i kontradiktoritetit në proces, sepse në padi nuk del e qartë nëse jemi para një konflikti me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kontraktore, apo për konflikt të rrjedhur nga shkaktimi i dëmit. Shkelja e këtij parimi na ka hequr mundësinë të përfitojmë nga parimi i kontradiktoritetit që gjen shprehjen në nenet 19 e 20 të Kodit të Procedurës Civile.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi përfaqësuesit e palës kërkuese, të subjektit të interesuarë dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Shoqëria "Trema Engineering", i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Tiranë me padi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kontraktore dhe shpërblimin e dëmit, me Shoqërinë "Buka" Sh.A, duke u bazuar në një kontratë magazinimi që mban datën 01.01.1997. Në përfundim të proceseve gjyqësore të gjitha gjykatat kanë lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas të cilës është pranuar padia e Shoqërisë "Trema Engineering".

Pretendimi i kërkuesit, sipas të cilit i gjithë procesi gjyqësor është bazuar në një kontratë inekzistente dhe është inicuar nga një palë tjetër dhe e palegjitimuar, nuk është i drejtë.

Nga pikëpamja formale kontrata e ndodhur në dosje që mban datën 01.01.1997 ka disa të meta që lidhen me origjinalitetin dhe gabime të karakterit material në drejtim të emrit të përfaqësuesit të Shoqërisë "Trema Engineering". Megjithatë këto mangësi nuk cënojnë thelbin e veprimit juridik të bërë me shkresë, të cilin palët nuk e kanë kontestuar gjatë gjykimit. Gjithashtu, Shoqëria "Buka" Sh.A, nëpërmjet përfaqësuesve të saj, gjatë të gjitha shkallëve të gjykimit nuk e ka mohuar ekzistencën e marrëdhënies juridike apo lidhjen e kontratës së magazinimit, si dhe nuk ka kërkuar në asnjë fazë të gjykimit saktësimin e ndërgjyqësisë. Në të gjitha materialet që ndodhen në dosje, del e qartë se kërkuesi ka pranuar që detyrimi i tij ndaj subjektit të interesuar është shuar si rrjedhojë e qënies përpara rastit "fator", dhe njëkohësisht pranon se detyrimi edhe nëse do të ekzistonte duhej të ishte shumë më i vogël nga sa ka vendosur gjykata. Prandaj pretendimi i kërkuesit se është shkelur parimi themelor i inicimit të procesit gjyqësor vetëm nga pala, që sanksionohet në nenin 2 të Kodit të Procedurës Civile, nuk është i drejtë.

Gjykata Kushtetuese çmon se edhe pretendimi tjetër i kërkuesit për shkelje të parimit të kontradiktoritetit nuk qëndron. Parimi i kontradiktoritetit si një ndër parimet më të rëndësishme që duhet të karakterizojnë procesin gjyqësor në kuptim edhe të neneve 18, 19 dhe 20 të Kodit të Procedurës Civile, lidhet me të drejtën e palëve ndërgjyqëse për t'u dëgjuar, për t'i bërë të njohur ato njëra-tjetrës në kohën e duhur mjetet dhe faktet mbi të cilat ato mbështesin të gjitha pretendimet e tyre, provat e grumbulluara, referencën e saktë ligjore, me qëllim realizimin sa më të drejtë të parimit të mbrojtjes së interesave të tyre në gjykim.

Kërkuesi në të gjitha shkallët e gjykimit nuk rezulton të jetë cënuar si rrjedhojë e shkeljes së këtij parimi. Padia nga Shoqëria "Trema Engineering" në gjykatën e shkallës së parë është ngritur me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kontraktore. Në seancën e datës 10.06.1997 është kërkuar nga pala paditëse saktësimi i bazës ligjore dhe gjykata ka vendosur mbi këtë kërkesë dhe referencën në nenin 455 të Kodit Civil, duke mos ndryshuar as shkakun apo objektin e padisë. Mbi këtë bazë palët i kanë patur të gjitha mundësitë që mbi pretendimet dhe provat e paraqitura të realizonin zbatimin në proces të parimit të kontradiktoritetit. Të gjitha gjykatat që kanë shqyrtuar këtë çështje kanë vendosur

mbi kërkesat e palëve, pa tejkaluar apo kufizuar ndonjë të drejtë të tyre.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë arrin në përfundimin se pretendimet e paraqitura nga kërkuesi lidhur me parregullsitë e procesit gjyqësor janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 dhe 132 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë si dhe nenet 45 e 72 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Hiqet masa e pezullimit datë 31.07.2000, e marrë me vendim të mbledhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 16.10.2000
Nr.53 i Regjistrit Themeltar.
Nr.69 i Vendimit.

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Bashkim Caka	Anëtar
Nikoleta Kita	"
Natasha Sheshi	"
Vladimir Metani	"
Vladimir Bineri	"
Valentina Kondili	"
Vitore Tusha	"
Ylvi Myrtja	"
Zamir Poda	"
Tefta Zaka	"
Vangjel Kosta	"
Petrit Plloçi	"
Artan Hoxha	"
Agron Lamaj	"
Perikli Zaharia	"

në seancën gjyqësore të datës 15.09.2000, në mbledhjen e Kolegjeve të Bashkuara, nën drejtimin e Thimjo Kondit, kryetar i Gjykatës së Lartë, morën në shqyrtim çështjen penale që i përket:

TË PANDEHURIT: Tom Lleshdedaj, lindur në Gjakovë - Kosovë dhe banues në Kroaci, hetuar dhe gjykuar në gjendje arresti në mungesë, mbrojtur në gjykim kryesisht nga avokati Enver Mema.

AKUZA: Veprën penale të mashtrimit të 78 personave në shumën 910 170 USD, parashikuar

nga neni 143 i Kodit Penal.

PADITËSA CIVILË: 1. Sami Kulla 2. Viktor Osmanlliu 3. Kamber Kamberaj 4. Arqile Lole 5. Dhimitraq Shkodrani

I PADITUR CIVIL:Tom Lleshdedaj

OBJEKTI : Kthim shume dhe shpërblim dëmi

BAZA LIGJORE: Neni 61 e vijues të Kodit të Procedurës Penale dhe nenet 445, 450, 1050, 1051 të Kodit Civil.

Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.292, datë 08.05.2000, ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Tom Lleshdedaj për veprën penale të mashtrimit dhe në bazë të nenit 143 të Kodit Penal e dënon me 5 (pesë) vjet burgim.

Ky dënim i fillon nga dita e ekzekutimit të vendimit.

Pas vuajtjes së dënimit të pandehurit i hiqet e drejta për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë për një afat prej 5 (pesë) vjetësh, parashikuar kjo nga nenet 40 e 44/2 të Kodit Penal.

Pranimin e padisë civile të ngritur në procesin penal.

Detyrimin e të paditurit civil Tom Lleshdedaj t'i kthejë paditësit civil Kamber Kamberaj shumën 5.000.000 (pesë milionë) lekë.

Detyrimin e të paditurit civil Tom Lleshdedaj t'i kthejë paditësit civil Viktor Osmanlliu shumën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë.

Detyrimin e të paditurit civil Tom Lleshdedaj t'i kthejë paditësit civil Sami Kulla shumën 200.000 (dyqind mijë) lekë.

Detyrimin e të paditurit civil Tom Lleshdedaj t'i kthejë paditësit civil Dhimitraq Shkodrani shumën 3 (tre) mijë USD dhe 700.000 (shtatëqind mijë) lekë.

Detyrimin e të paditurit civil Tom Lleshdedaj t'i kthejë paditësit civil Arqile Lole shumën 2. 256.800 (dy milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e teteqind) lekë dhe interesin bankar nga data 6.8.1996 e deri në ditën e ekzekutimit të vendimit.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 284, datë 26.06.2000, ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.292, datë 8.5.2000 të Gjykatës së Rrethit Tiranë si më poshtë:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Tom Lleshdedaj për veprën penale të mashtrimit ndaj të dëmtuarve Ilir Loli për vlerën 10.000 USD, Muharrem Doçi në vlerën 10.000 USD, Hekuran Rushiti në vlerën 12 500 USD, Jorgo Rrapi në vlerën 1000 USD, Jani Bita në vlerën 500 USD, Eduart Pashollari në vlerën 1000 USD, Pirro Beqiri në vlerën 13 000 USD, Agim Basha në vlerën 1 000 000 lekë, Manushaqe Sinjali në vlerën 1 600 000 lekë, Dashnor Cenomeri në vlerën 14 500 USD, 1 600 000 lekë, Zenel Bajraktari në vlerën 6000 USD dhe në bazë të nenit 104/2 të Kodit Penal të vjetër e dënon me 5 (pesë) vjet heqje lirie.

Dekarimin fajtor të të pandehurit Tom Lleshdedaj për veprën penale të mashtrimit ndaj të dëmtuarve për 47 herë, në bazë të nenit 143 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me masat e dënimit nga minimumi 1 muaj heqje lirie deri në maksimumin 3 vjet heqje lirie (sipas dispozitivit).

Në bashkim të dënimeve në bazë të nenit 55/2 të Kodit Penal i pandehuri Tom Lleshdedaj dënohet me 8 (tetë) vjet heqje lirie.

Detyrimin e të pandehurit Tom Lleshdedaj t'u kthejë të dëmtuarve shumat respektive sipas aktit të ekspertimit kontabël të shprehur në dispozitiv.

Lënien në fuqi të vendimit nr. 292, datë 8.5.2000 të Gjykatës së Rrethit Tiranë ku është vendosur që pas vuajtjes së dënimit të të pandehurit Tom Lleshdedaj t'i hiqet e drejta për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë për një afat prej 5 (pesë) vjetësh, në bazë të neneve 40 e 42/2 të Kodit Penal dhe për shpenzimet gjyqësore që i janë lënë në ngarkim të pandehurit.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit ka paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- se nuk jemi dakord me masën e dënimit të dhënë nga gjykata e apelit prej 8 (tetë) vjet burg, ajo duhet t'i jepte maksimumin e masës së dënimit të nenit 143 të Kodit Penal dhe në bashkim të dënimeve t'i jepte një masë dënimi më të ashpër,

- se gjykata nuk ka patur parasysh faktin që i pandehuri i është shmangur hetimit dhe gjykimit, nuk ka patur parasysh pasojat e rënda sociale që sollën firmat piramidale në Shqipëri, si dhe faktin që ky i pandehur nuk ka shlyer detyrimet ndaj kreditorëve.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit ka paraqitur rekurs mbrojtësi i caktuar kryesisht i të pandehurit, av. Enver Mema, i cili kërkon prishjen e vendimit të gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit Tiranë përsa i përket fajësisë, cilësimit juridik e padisë civile, kurse përsa i përket masës së dënimit për 5 vjet, që është maksimumi i dispozitës së nenit 143, kërkon uljen e saj, duke parashtruar këto shkaqe: se vendimi i gjykatës së apelit është alogjik dhe haptazi i padrejtë, se nuk mund të zbatohen të dy dispozitat e kodeve penale të ndryshme për të njëjtën vepër penale, por ajo që është më e favorshme për të pandehurin, se është i pabazuar pretendimi i gjykatës, se Kodi i Ri Penal nuk e pranon krimin vazhdues, ai duhet të konsiderohet si pjesë e të njëjtës vepër penale dhe jo vepra penale më vete, se ka shkelje ligji kur gjykata zbaton për të njëjtën vepër dy dispozita të kodeve të ndryshme,

- se gjykata ka shkelur nenin 62 të Kodit të Procedurës Penale, përsa i përket padisë civile, ku thuhet se legjitimimi i paditësit civil bëhet derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor,

- se gjykata në kundërshtim me ligjin, pranon si palë kryetarin e grupit të mbikqyrjes, kur padia ngrihet personalisht nga paditësi civil,

- se për kreditorët gjykata ka bërë gjykime për së dyti, kur në fakt jemi para gjësë së gjykuar.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtarit Bashkim Caka, dhe të gjyqtarit Vangjel Kosta, mbasi dëgjuan prokurorin Mihallaq Bleta, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit penal nr.284, datë 26.6.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke e dënuar me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burg, shkaqet e rekursit dhe mbasi shqyrtuan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë :

Personi që ka kryer mashtrime do të përgjigjet penalisht për veprën penale të mashtrimit parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, aq herë sa është numri i personave të dëmtuar.

Ka rezultuar gjatë gjykimit se i pandehuri Tom Lleshdedaj në vitin 1993 ka themeluar shoqërinë tregtare me emrin “Agron” duke qenë me cilësinë e ortakut të vetëm. Në vitin 1994 i pandehuri ka filluar të marrë hua nga persona të ndryshëm sipas kontratave përkatëse, të cilat parashikonin një interes prej 6-12 % në muaj. Në këtë mënyrë ai ka mundur të marrë shuma të ndryshme parash me një vlerë të përgjithshme prej 910.971 USD, të cilat u përkisnin 78 personave të ndryshëm. Për të krijuar bindjen se ishte shoqëri serioze dhe që garantonte kthimin e shumave të marra hua së bashku me interesat, fillimisht i pandehuri ka shlyer disa interesa. Më vonë, duke përdorur gënjeshtrën se do të kryente investime të ndryshme, ka ndërprerë pagesat. Por, nga gjykimi është provuar se ky i pandehur nuk ka kryer asnjë investim dhe, realisht nuk disponon asnjë aset a pasuri tjetër deri sa më 1998 është larguar nga Shqipëria, duke marrë edhe paratë e mbledhura nëpërmjet kontratave të huasë.

Në keto rrethana, konkluzioni i gjykatave se i pandehuri Tom Lleshdedaj ka konsumuar veprën penale të “mashtrimit” është i bazuar në ligj. I pandehuri ka përdorur gënjeshtrën për të shtënë në dorë paratë e personave me të cilët në mënyrë fiktive ka lidhur kontratat e huamarrjes. I pandehuri ka paraqitur rrethana të tilla para personave të lartpërmendur për t’i bindur ata se ai ushtronte një veprimtari të ligjshme tregtare me anë të së cilës mund të siguronte fitime qe tejkalonin atë pjesë të interesit të premtuar kreditorëve. Por, gjatë gjykimit është provuar në mënyrë bindëse se veprimtaria huamarrëse e ushtruar prej të pandehurit është veprimtari e paligjshme. Sipas nenit 1 të ligjit nr.7560 datë 28.04.1992 “Për sistemin bankar në Shqipëri” veprimtaria tregtare e “pranimit të depozitave” mund të ushtrohej eskluzivisht nga një institucion financiar i pajisur me licensë të posaçme sipas kushteve dhe nga organi që parashikon ligji i sipërcituar. Duke qenë në të njëjtën kohë edhe një marrëdhënie juridike-civile ajo mund të realizohet edhe në veprimtarinë civile por vetëm në kushtet që nuk përfaqëson një veprimtari tregtare. Në rastin konkret, veprimtaria e “pranimit të depozitave” është ushtruar në përmasat e një veprimtarie tregtare. Prandaj, subjekt i ushtrimit të kësaj veprimtarie tregtare mund të jenë vetëm institucionet financiare që parashikon ligji i lartpërmendur.

Përsa i përket cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri nga gjykatat janë mbajtur qëndrime të ndryshme.Gjykata e shkallës së parë, duke arsyetuar se "vepra penale e kryer nga i pandehuri është unike dhe se ai ka patur mendim të njëjtë kriminal" e ka konsideruar krimin "vazhdues" dhe ka dënuar të pandehurin vetëm një herë sipas nenit 143 të K. Penal.

Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë duke pranuar se për çdo person të mashtruar i pandehuri ka konsumuar veprën penale të mashtrimit në mënyrë të veçantë.

Lidhur me trajtimin e ekzistencës së krimit vazhdues në veprimet e këtij të pandehuri, duke u nisur nga ekzistenca e praktikave të ndryshme të mëparshme për çështje analoge, Kryetari i Gjykatës së Lartë ka vendosur "gjykimin e kësaj çështjeje në Kolegjet e Bashkuara" me qëllim unifikimin e praktikës përsa i përket "ekzistencës ose jo të krimit vazhdues".

Në rastin konkret problemi shtrohet nëse do te kemi krim vazhdues, d.m.th, një vepër të vetme penale të mashtrimit të kryer prej të pandehurit Tom Lleshdedaj.

Për të zgjidhur drejt këtë problem duhet të mbahet parasysh se për të patur krim vazhdues duhet të jenë të pranishëm elementë të tillë si; secila vepër nuk duhet të qëndrojë si akt më vehte, veprimet ose mosveprimet e të pandehurit të konsumojnë të njëjtën figurë të veprës penale, të ekzistojë një mendim kriminal, i cili të bashkojë aktet e veçanta në një tërësi të vetme të pandashme" . Për të patur krim vazhdues është e domosdoshme që personi të ketë parashikuar hollësitë rreth veprimtarisë së tij kriminale siç janë, koha, mjetet, forma, mënyra për kryerjen e krimit. Mendimi i vetëm kriminal, si bosht i kërkësës për krimin vazhdues, presupozon që i pandehuri të ketë përpunuar në mendjen e tij zhvillimin e veprimeve konkrete në kohë e hapësirë. Pavarësisht se është "mendim" ai "lexohet" nëpërmjet veprimeve konkrete që kryen i pandehuri për realizimin e veprës penale.

Në rastin konkret gjykatat kanë pranuar se i pandehuri ka kryer veprime të ndryshme në periudha të ndryshme kohe për të rritur sa më shumë numrin e personave të mashtruar.

Kështu, aktiviteti kriminal është zhvilluar në një kohë relativisht të gjatë dhe veprimet e të pandehurit nuk kanë qenë rrjedhojë e një mendimi të vetëm kriminal të përpunuar në momentin që vendosi të kryejë këtë veprimtari kriminale, por kanë ndryshuar në varësi të rrethanave. Kështu, duke patur parasysh se persona të ndryshëm kanë patur marrëdhënie të ndryshme me të, ai ka përdorur forma të ndryshme mashtrimi. Për personat e njohur drejtpërdrejt prej tij, i pandehuri ka shpërdoruar besimin, ndërsa përsa u përket personave të tjerë, ka përdorur gënjeshtrën e "ushtrimit të veprimtarisë së ligjshme tregtare". Vetë veprimet e të pandehurit si, qendrimi i ndryshëm lidhur me pagesat e interesave, marrja e objekteve më pas me qira për të "bindur" fillimin e investimeve dhe sidomos ndryshimi i shkallës së interesit tregojnë në mënyrë të qartë mungesën e një mendimi të vetëm paraprak kriminal.

Argumenti i përdorur nga gjykata e shkallës së parë, se ndodhemi para një vepre të vetme penale, pra para krimit vazhdues pasi "i pandehuri që në fillim kishte kristalizuar në ndërgjegjen e tij një mashtrim sa më të madh që të ishte i mundur pavarësisht nga numri i personave që u mashtruan", nuk është llogjik dhe i bazuar në ato elementë të anës objektive të kryerjes së veprës penale që vetë kjo gjykatë i pranon. Qëllimi në të cilin synon të arrijë autori i krimit, motivi apo shkaku i përbashkët nga është nxitur ai në kryerjen e akteve të veçanta, nuk mund të çojnë në konkluzionin se këto akte duhet të bashkohen në një të vetëm.

Duke marrë parasysh sa më sipër, gjykata e apelit me të drejtë veprën e kryer nga ana e të pandehurit, lidhur me mashtrimin e kryer prej tij për 11 persona para se të hynte në fuqi Kodi i ri Penal, e ka cilësuar në bazë të nenit 104/2 të Kodit Penal të mëparshëm.

Ndërsa për personat e mashtruar mbas hyrjes në fuqi të Kodit të ri Penal, vepra e të pandehurit është kualifikuar në bazë të nenit 143 të Kodit Penal, aq herë sa ka qenë numri i personave të dëmtuar, të mashtruar prej tij. Në këtë aspekt nga kjo gjykatë, është respektuar drejtë përmbajtja e nenit 3, paragrafi i tretë i Kodit Penal në fuqi sipas të cilit, "kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale". Interpretimi i kësaj dispozite të shpie në konkluzionin se nuk mund të jepet një dënim më i lartë për personin se sa dënimi që zbatohej për veprën penale në kohën që është kryer.

Është detyrë e gjykatës që të shqyrtojë me kujdes dispozitat përkatëse, për të përcaktuar se cila është dispozita penale më e favorshme për personin. Kjo arrihet nga gjykata nëpërmjet vlerësimit të kujdesshëm të dispozitivit të dispozitës penale dhe krahasimit të minimumit e maksimumit të dënimit si dhe të dënimeve alternative të parashikuara nga secila dispozitë.

Përsa i përket çështjes në shqyrtim, duhet theksuar se në nenin 104/2 të Kodit Penal të mëparshëm, ishte parashikuar si rrethanë cilësuese kryerja e mashtrimit më shumë se një herë, pra përsëritja. Në këtë mënyrë, kryerja e veprës më shumë se një herë ishte pjesë përbërëse e figurës së krimit dhë shërbenin për cilësimin ligjor të tij. Madje në këtë rast nuk zbatohej dispozita e pjesës së përgjithshme të Kodit Penal që parashikonte "rrethanat rënduese" sepse ato parashikoheshin në vetë ndërtimin e figurës së krimit të mashtrimit të kryer më shumë se një herë, siç është paragrafi i dytë i nenit 104 të këtij kodi. Pavarësisht se cili ishte numri i personave të mashtruar apo dhe koha e kryerjes së mashtrimit të tyre, vepra penale e kryer nga i pandehuri dënohej vetëm një herë në bazë të kësaj dispozite.

Ndërsa në Kodin Penal në fuqi, në ndryshim nga Kodi Penal i mëparshëm, në përgjithësi "kryerja e veprës më shumë se një herë", apo "përsëritja" nuk parashikohen si elementë përbërës të veprës penale. Kështu, edhe neni 143 i këtij kodi që parashikon se "vjedhja e pasurisë me anë të gënjeshtrës ose shpërdorimit të besimit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet", nuk shprehet për kryerjen e kësaj vepre më shumë se një herë. Të njëjtin qëndrim mban kodi penal edhe për vepra penale të tjera më të rënda, si vrasja, vrasja me paramendim, vjedhja, vjedhja me dhunë, shkatërrimi i pronës, e të tjera.

Kjo nuk ka kuptimin e zbutjes së ndëshkimit nga Kodi i ri Penal të veprave të kryera më shumë se një herë. Përmbajtja e Kodit të ri Penal, është se personi fajtor do të përgjigjet penalisht për aq vepra penale që ai kryen. Sipas Kodit Penal të mësipërm (neni 31, germa "a" e Kodit Penal) me përsëritje kuptoheshin rastet e kryerjes nga personi më parë të një ose më shumë veprave penale, qofshin këto të njëllojta apo të llojeve të ndryshme, pavarësisht se ai kishte qenë ose jo i dënuar më parë dhe kur kjo (përsëritja) nuk ishte element përbërës i veprës penale. Në këtë rast, kur dispozita përkatëse nuk e parashikonte përsëritjen si element përbërës të figurës së krimit, vepra cilësohej si e kryer në rrethana rënduese, ndërsa kur dispozita penale e parashikonte përsëritjen si rrethanë cilësuese, nuk zbatoheshin rrethanat rënduese.

Bazuar në këto argumenta arrihet në përfundimin se ligji i kohës kur janë kryer 11 mashtrimet nga i pandehuri, pra neni 104/2 të Kodit Penal është dispozitë më e favorshme se dispozita e mëvonshme, që parashikon krimin e mashtrimit, mbasi siç u theksua, i pandehuri duhet të deklarohet fajtor dhe të dënohet për veprën penale të mashtrimit, aq herë sa ka qenë dhe numri i personave të mashtruar. Në këtë mënyrë për këtë person, duke u bërë caktimi i dënimeve për disa vepra penale në përputhje me nenin 55 të Kodit Penal, masa e dënimit e kalon atë të parashikuar në maksimum nga dispozita e mëparshme penale.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, bazuar në rastet e mashtrimit të realizuar nga i pandehuri, shumat e parave të marra prej tij, rrethanat në të cilat kanë ndodhur krijimi i firmave piramidale, çmon se masa e dënimit të dhënë të pandehurit është në përputhje me rrezikshmërinë e tij shoqërore dhe të veprës së kryer.

Nga ky kolegj çmohet se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, duhet të prishet vetëm përsa i përket padisë civile në këtë proçes penal, për arsye se janë lejuar shkelje të ligjit.

Gjykata ka zbatuar gabim ligjin procedurial në trajtimin e padisë civile në procesin penal. Nga aktet rezulton se kjo padi është paraqitur para gjykatës së Apelit, e cila pasi e ka shqyrtuar atë ka konkluduar në bazueshmërinë e saj në prova e në ligj dhe ka detyruar të pandehurin, me cilësinë e të padituri civil që të paguajë shumat e përfituara nëpërmjet veprës penale të mashtrimit.

Kjo padi është pranuar për t'u shqyrtuar prej gjykatës së Apelit pa patur parasysh nenin 62 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas kësaj dispozite " Legjitimimi i paditësit civil (në procesin penal) mund të bëhet nga organi procedues, derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor", dhe se " ky afat nuk mund të zgjatet". Ky rregullim është i qartë, ndërsa gjykata e Apelit ka vepruar në kundërshtim me këtë rregull pa sqaruar moszbatimin e tij.

"Mosfillimi i shqyrtimit gjyqësor", sipas dispozitës së mësipërme i referohet "shqyrtimit gjyqësor" në tërësi, pra "mosfillimit të shqyrtimit gjyqësor" në gjykatën e shkallës së parë.

Ky konkluzion buron nga vetë konceptimi i institutit procedurial të "gjykimit të padisë civile në procesin penal". Padia civile në rastin konkret nuk ka dallim nga "padia civile" sipas konceptimit nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Dallimi në këtë rast ka të bëjë vetëm me faktin se kjo padi civile, për shkak të specifikës se lidhet "me dëm material nga vepra penale" do të gjykohet nga gjykata penale së bashku me procedimin penal. Ky rregullim i veçantë nga rregulli i përgjithshëm i gjykimit të padive civile nga gjykata civile duke vlerësuar oportunitetin e bashkimit të dy gjykimeve, të cilat kanë

të përbashkëta palët, provat e nevojshme etj. Ky bashkim nuk mund të cënojë as procedimin penal dhe as atë civil. Të dy procedimet ruajnë karakteristikat e tyre të veçanta sipas dispozitave respektive që i rregullojnë por, për shkak të elementëve të përbashkët bashkohen në një procedim të përbashkët. Për rrjedhojë, siç shprehet edhe neni 62 i Kodit të Procedurës Penale, padia civile nuk mund të paraqitet në një fazë procedimi që nuk e parashikon Kodi i Procedurës Civile.

Ky procedim nuk mund të fillojë në gjykatën e shkallës së dytë, siç ka vepruar gjykata e Apelit, pasi do të ndodheshim para cënimit të parimit të respektimit të shkallëve të gjykimit civil të parashikuar në nenin 135 të Kushtetutës dhe të përshkruar hollësisht në ligjin procedurial.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të neneve 438, 441 të K. Pr. Penale dhe nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.03.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S Ë N :

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 284 datë 26.06.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë lidhur me deklarimin fajtor dhe dënimin përfundimtar të të pandehurit Tom Lleshdedaj për
veprën penale të mashtrimit.

2. Prishjen e vendimit nr. 284 datë 26.06.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë lidhur me shqyrtimin e padisë civile të paditësave civile përfaqësuar prej Grupit Mbikqyrës kundër të padituri civil Tom Lleshdedaj dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e rrethit Tiranë.

3. Një kopje e këtij vendimi unifikues të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 06.10.2000
Nr.340 i Regjistrit Themeltar
Nr.284 i Vendimit

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Thimjo Kondi,	Kryetar
Bashkim Caka,	Anëtar
Agron Lamaj,	“
Vitore Tuasha,	“
Artan Hoxha,	“
Valentina Kondili,	“
Nikoleta Kita,	“
Natasha Sheshi,	“
Vladimir Metani,	“
Vladimir Bineri,	“
Perikli Zaharia,	“
Tefta Zaka,	“
Ylvi Myrtja,	“
Vangjel Kosta,	“
Petrit Plloçi,	“

në seancat gjyqësore të datës 15.09.2000, mori në shqyrtim çështjen civile nr. 1921, që i përket:

PADITËS : Trashegimtarët e Mane Zallit

I PADITUR:1.Trashegimtarët e Ahmet Dulit, 2.Trashegimtarët e Abdyl Dulit

PERSONA TE TRETË: 1. Dega e AKP, Shkodër, 2. Ndërmarrja Jometalore, Shkodër, 3. Gjovalin Lasku

OBJEKTI I PADISË: Kërkimin e trashëgimit, në bazë të nenit 350 të Kodit Civil,

Gjykata e Rrethit Shkodër, me vendimin nr.180, datë 13.02.1998, ka vendosur :

Njohjen e Mane Zallit (Sylja) trashëgimtarë mbi objektet me të drejtë parablerje të ish-ndërmarrjes jometalore Shkodër. Detyrimin e trashëgimtarëve të Ahmet Dulit t’u kthejnë trashëgimtarëve të Mane Zallit shumën 703.333 lekë, kundërvleftë e objekteve të shitura nga trashëgimia e këtyre të fundit. Detyrimin e trashëgimtarëve të Avdul Dulit t’u kthejnë trashëgimtarëve të Mane Zallit shumën 641.473 lekë, kundërvleftë e objekteve të shitura të trashëguara nga Mane Zalli.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 231, datë 25.06.1999, ka vendosur:

Prishjen e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Shkodër dhe gjykimin e çështjes në këtë gjykatë si shkallë e parë.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit kanë paraqitur rekurs paditësat, trashëgimtarët e Mane Zallit, duke parashtruar këto shkaqe :

- Gjykata e apelit Shkodër, me vendimin nr.131, datë 16.07.1998, kishte prishur vendimin nr.180, datë 13.02.1998, të gjykatës së rrethit Shkodër. Mbi rekursin tonë, Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër dhe ia ka dërguar çështjen për rigjykim po asaj gjykate, me arsyetimin se shkeljet e vërtetuara nga gjykimi i kësaj çështje nga gjykata e shkallës së parë, nuk përbëjnë shkaqe ligjore për dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, por duhet të plotësohen nga gjykata e apelit. Në rigjykim gjykata e apelit, në kundërshtim me konkluzionet e Gjykatës së Lartë, e ka prishur përsëri vendimin e gjykatës së shkallës së parë, dhe në bazë të nenit 467/a e ka mbrojtur çështjen vetë për gjykim si gjykatë e shkallës së parë. Ky vendim është i paligjshëm, dhe si i tillë duhet të prishet dhe çështja duhet të dërgohet për rigjykim. Meqë gjyqtarët e gjykatës së apelit Shkodër kanë marrë pjesë në gjykimin e kësaj çështje, kërkojmë dërgimin e saj për rishqyrtim Gjykatës së Apelit Tiranë.

- Me vendimin datë 7.6.2000, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë çështja është sjellë në Kolegjet e Bashkuara për njësimin e praktikës gjyqësore, duke arsyetuar, se Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr.231, datë 25.6.1999, ka prishur vendimin nr.180, datë 13.2.1998, të Gjykatës së Rrethit Shkodër dhe e ka mbajtur çështjen për ta gjykuar vetë si shkallë e parë, por që akoma nuk e ka shqyrtuar. Pikërisht, kundër këtij vendimi të gjykatës së apelit, paditësat kanë paraqitur rekurs në

Gjykatën e Lartë. Në këtë drejtim, nga çështjet e gjykuara deri tani në Gjykatën e Lartë, vërehet se gjykatat e apelit nuk kanë praktikë të njëjtë. Disa gjykata mbajnë qëndrimin e mësipërm, ndërsa gjykata të tjera kur e mbajnë çështjen për gjykim në bazë të nenit 467/a të Kodit të Procedurës Civile, e zgjidhin atë në një gjykim.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pas relatimit të gjyqtarit Petrit Plloçi, pasi u dëgjua përfaqësuesi i paditësit Gani Zalli, av. Haki Kraja, i cili kërkoi mospranimin e kërkesës së Kolegjit Civil dhe dërgimin e çështjes atij kolegji për dhënien e vendimit përfundimtar, ose prishjen e vendimit nr.231, datë 25.6.1999 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes në atë gjykatë me tjetër trup gjykues, ose prishjen e vendimit nr.231, datë 25.6.1999, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe lënien në fuqi të vendimit nr.180, datë 13.2.1998 të Gjykatës së Rrethit Shkodër, pasi dëgjoi prokurorin Bujar Sheshi, i cili kërkoi prishjen e vendimit nr.231, datë 25.6.1999, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po në këtë gjykatë, e pasi e bisedoi çështjen,

V Ë R E J N Ë :

Në aplikim të nenit 467/a të Kodit të Procedurës Civile, kur gjykata e apelit prish vendimin për herë të dytë dhe e mban çështjen për ta shqyrtuar vetë si shkallë e parë, çështja shqyrtohet nga i njëjti trup gjykues pa e ndërprerë gjykimin.

Kështu, nga shqyrtimi i çështjes në Kolegjet e Bashkuara, ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Shkodër, me vendimin nr.180, datë 13.2.1998, ka pranuar padinë me objekt pavlefshmërinë e kontratës së shitblerjes datë 4.3.1996. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.131, datë 16.7.1998 ka prishur vendimin e mësipërm të gjykatës së rrethit dhe e ka dërguar çështjen për rigjykim po në këtë gjykatë me trup gjykues tjetër. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.221, datë 9.03.1999, ka prishur vendimin e mësipërm të gjykatës së apelit dhe e ka dërguar çështjen për rigjykim po në këtë gjykatë me trup gjykues tjetër. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr.231, datë 25.6.1999, ka prishur vendimin nr.180, datë 13.2.1998, të Gjykatës së Rrethit Shkodër dhe në aplikim të nenit 467/a të Kodit të Procedurës Civile, e ka mbajtur çështjen për ta gjykuar vetë si shkallë e parë, por që akoma nuk e ka shqyrtuar. Pikërisht kundër këtij vendimi të fundit të gjykatës së apelit, paditësat kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

Pra siç shihet, gjykata e apelit vetëm ka prishur vendimin e gjykatës së rrethit pa e zgjidhur çështjen në themel. Në këtë drejtim, nga çështjet e gjykuara deri tani në Gjykatën e Lartë, vërehet se gjykatat e apelit nuk kanë praktikë të njëjtë. Disa gjykata mbajnë qëndrimin e mësipërm, ndërsa gjykata të tjera, kur e mbajnë çështjen për gjykim në bazë të nenit 467 a të Kodit të Procedurës Civile, e zgjidhin atë në një gjykim.

Në rrethanat e mësipërme, çështja shtrohet nëse në aplikim të nenit 467/a të Kodit të Procedurës Civile, gjykata e apelit në të njëjtin gjykim, pra i njëjti trup gjykues, prish për herë të dytë vendimin e gjykatës së rrethit dhe po ky trup gjykues, e shqyrton çështjen si shkallë e parë në të njëjtin gjykim, apo vetëm prish vendimin e gjykatës së rrethit, ndërsa gjykimi si shkallë e parë bëhet veças, qoftë edhe me një trup gjykues tjetër. Neni 467/a parashikon, se Gjykata e Apelit kur prish vendimin nuk mund ta kthejë çështjen për rigjykim për të dytën herë por e shqyrton vetë si gjykatë e shkallës së parë. Termi "gjykata e apelit" në dispozitën e mësipërme është përdorur në kuptimin procedural, e jo institucional, e si i tillë nënkupton trupin gjykues. Për pasojë, kur dispozita shprehet se Gjykata e Apelit e shqyrton vetë çështjen si shkallë e parë, kjo ka kuptimin se çështja shqyrtohet nga i njëjti trup gjykues pa e ndërprerë gjykimin. Shprehja "si gjykatë e shkallës së parë" nuk do të thotë se në këto raste gjykata e apelit paraqitet si shkallë e parë, por se ashtu si në rastin që parashikon neni 465 i po këtij Kodi, edhe në rastin e aplikimit të nenit 467/a, gjykata e apelit mund të përsërisë tërësisht ose pjesërisht hetimin gjyqësor. Në të kundërtën, në rast se ligjvënësi do të kishte për qëllim që gjykata e apelit në këtë rast do të gjykonte në shkallë të parë, atëherë duhet të kishte parashikuar edhe të drejtën e një ankimi kundër vendimit të kësaj gjykate, gjë që nuk e ka bërë. Përveç kësaj, nëpërmjet kësaj dispozite, ligjvënësi ka patur për qëllim të bëjë ekonomi gjyqësore, pra të reduktojë zvarritjet e gjykimit. Po të pranosh të kundërtën, pra, që në aplikim te nenit 467/a, kur çështja gjykohet për herë të dytë nga gjykata e apelit, bëhen dy gjykime, njëri si gjykatë apeli dhe i dyti si gjykatë e shkallës së

parë, gjë që nuk përjashton gjykimin e çështjes nga një trup tjetër gjykues, atëherë do te zvarritej gjykimi në të njëjtën mënyrë sikur çështja mbas prishjes nga gjykata e apelit të dërgohej për rigjykim ne gjykatën e shkallës së parë.

Për pasojë, në këto raste, në një gjykim, me një vendim përfundimtar, gjykata e apelit edhe prish për herë të dytë vendimin e gjykatës së rrethit edhe e zgjidh çështjen ne themel. Për pasojë, vendimi i gjykatës së apelit është i gabuar, e si i tillë duhet të prishet.

Në këto kushte, çështja duhet të dërgohet në Gjykatën e Apelit Shkodër për vazhdimin e gjykimit nga i njëjti trup gjykues për të zgjidhur çështjen në themel.

Pretendimi i palës paditëse, se në rastin në shqyrtim nuk ka vend për të marrë vendim për njësimin e praktikës gjyqësore, nuk është i bazuar. Për të marrë një vendim të tillë nuk është e domosdoshme që të paraqiten dy ose më tepër vendime të Kolegjeve të veçanta të Gjykatës së Lartë që kanë dhënë zgjidhje të ndryshme për çështje të ngjashme. Vendim për njësimin e praktikës gjyqësore mund të merret edhe në rastet kur nga vendimet e dhëna më parë nga gjykatat e të gjitha shkallëve për çështje të ngjashme janë bërë zgjidhje të ndryshme duke interpretuar gabim ligjin.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 485 te K. Pr. Civile, e nenin 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”,

V E N D O S Ë N :

Prishjen e vendimit nr.231, datë 25.06.1999, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes po në këtë gjykatë për vazhdimin e gjykimit me të njëjtin trup gjykues për të zgjidhur çështjen në themel.

Ky vendim për njësimin e praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIM PARALEL

Çështja ka kaluar për gjykim pranë Kolegjeve te Bashkuara për njesimin e praktikës gjyqësore në lidhje me zbatimin e kërkesave proceduriale të parashikuara nga neni 467/a i Kodit të Procedurës Civile, konkretisht se çfarë veprimesh proceduriale do të kryejë gjykata në këtë rast.

Shumica konkludoi se prishja e vendimit do të bëhet me zgjidhjen përfundimtare të çështjes duke zbatuar gjatë gjykimit kërkesat e nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile .

Ne nuk jemi dakord me mendimin e shumicës përsa më poshtë :

Nga interpretimi i nenit 467/a i Kodit të Procedurës Civile rezulton se kjo dispozitë do të zbatohet në ato raste kur gjykata e apelit do të konkludojë për prishjen e vendimit të çështjes objekt i shqyrtimit të saj kuptohet për herë të dytë, por që nuk mund të zgjidhë çështjen përfundimisht pa kryer veprime të tjera poceduriale, që lidhen me zbatimin e ligjit dhe administrimin e provave (neni 467 i Kodi i Procedurës Civilë). Sipas kërkesës proceduriale ajo nuk duhet të kthejë çështjen për rigjykim por e shqyrton vetë si gjykatë e shkallës së parë. Parashtrojmë se në këtë rast gjykata duhet të vendosë prishjen e vendimit dhe mandej ta shqyrtojë çështjen pasi një kërkesë e tillë është taksative nga vetë dispozita .

Vendimi që shqyrton gjykata e apelit është vendim përfundimtar në kuptim të nenit 126 të Kodit të Procedurës Civile, pra mund të jetë zgjidhur çështja në themel ose është një vendim që i ka dhënë fund procesit gjyqësor .

Nisur nga sa sipër shtrohet çështja :

Kur gjykata e apelit shqyrton një vendim përfundimtar a mund ta cenojë atë me një vendim të marrë gjatë seancave gjyqësore, pra me vendim të ndërmjetëm?

Përgjigja jonë është se duke patur parasysh ruajtjen e ekuilibrit, vendimit përfudimtar, gjykata duhet t’i përgjigjet gjithmonë me një vendim përfundimtar, pra gjykata e apelit, kur do të konkludojë gjatë shqyrtimit të çështjes prej saj si gjykate apeli se duhet te prishë vendimin, duhet të shprehet me vendim përfundimtar për prishjen e tij dhe për shqyrtimin e çështjes si gjykatë e shkallës së parë (gjithmonë kur nuk mund të kthehet për rigjykim për herë të dytë).

Mandej nëse do ta gjykojë ai trup gjykues apo tjetër mendojmë se është problem i zgjidhur. Nuk ka asnjë pengesë ligjore për ta shqyrtuar çështjen si gjykatë e shkallës së parë, qoftë dhe ai trup gjykues (duke zbatuar rregullat për shqyrtimin e çështjes), për më tepër kur dhe njeh çështjen, por nuk është shprehur për zgjidhjen në themel të saj.

Evidentojmë problemin ligjor të veprimit procedurial që duhet të kryhet nga gjykata e apelit në ato raste kur ajo duhet ta shqyrtojë çeshtjen si gjykatë e shkallës së parë në bazë të nenit 467/a të Kodit të Procedurës Civile .

Mendimi i shumicës, se gjykata duhet të shprehet me vendim përfundimtar të zgjidhjes së çështjes duke zbatuar kërkesat e nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile, në rastin konkret nuk qëndron, pasi midis nenit 465 e 467/1 të Kodit të Procedurës Civile, ka dallim.

Kërkesat e nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata e apelit mund t'i zbatojë në çdo shqyrtim të çështjes në apel , pavarësisht nga cenimi ose jo i vendimit. Në të kundërt zbatimi i nenit 467/a të Kodit të Procedurës Civile bëhet vetëm atëherë kur gjykata e apelit prish vendimin, pra detyrimisht duhet të vendoset prishja e vendimit dhe mandej të shqyrtohet çështja prej saj si gjykatë e shkallës së parë. Në rast se nuk do të prishej për herë të dytë vendimi, në këtë gjendje të procesit gjyqësor çështja duhej t'i kthehej gjykatës së shkallës së parë , por në këtë rast gjykata e apelit duhet ta gjykojë vetë si gjykatë e shkallës së parë. Nisur nga sa sipër, rezulton se në këto raste konstatohen shkelje të procedurës të parashikuara nga neni 467 të Kodit të Procedurës Civile, sepse vetëm kur konkurojnë shkaqet e parashtruara në këtë dispozitë mund të dërgohet çështja për rigjykim dhe kur prishet vendimi për herë të dytë duhet ta mbajë vetë për shqyrtim gjykata e apelit . Pra kërkesat e nenit 467/a janë detyruese, kurse kërkesat e nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile janë fakultative, sepse gjykata e apelit sipas tij mban parasysh për aq sa janë të zbatueshme dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, përserit hetimin gjyqësor, mund të lexojë aktet dhe ka të drejtë të marrë prova të reja, kurse sipas nenit 467/a duhet ta shqyrtojë çështjen vetë si gjykatë e shkallës së parë, pra është e detyruar të veprojë si gjykatë e shkallës së parë duke mos pasur asnjë kufizim. Në aspektin teorik formal, pa patur parasysh përmbajtjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër për çështjen konkrete, por vetëm nga fakti se çfarë veprimesh proceduriale duhet të kryejë gjykata e apelit kur prish vendimin për herë të dytë, gjykata e apelit ka vepruar drejt. Vendimi do të konsiderohej i drejtë në rast se arsyetimi i tij do të ishte ligjor në përmbajtje. Në rastin konkret çështja i ka kaluar për rishqyrtim gjykates së apelit pas prishjes së vendimit të saj prej Gjykatës së Lartë. Gjykata e apelit duke mos zbatuar udhëzimet dhe konkluzionet e Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit për ato arsye ligjore që Gjykata e Lartë ka arsyetuar ndryshe.Udhëzimet dhe konkluzionet e Gjykatës së Lartë janë të detyrueshme të zbatohen prej gjykatës që rishqyrton çështjen dhe për rrjedhojë gjykata e apelit ka dhënë një vendim jo të drejtë.

Nisur nga sa sipër jemi dakord me zgjidhjen përfundimtare të çështjes për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes asaj gjykate për rishqyrtim, por vetëm sepse janë shkelur kërkesat e parashikuara nga neni 486 i Kodit të Procedurës Civile .

ANËTARË: V. KONDILI, V.METANI, T. ZAKA, V. KOSTA

Tiranë më 29.09.2000
Nr. 1921/627 i Regjistrit Themeltar.
Nr. 979 i Vendimit

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Bashkim Caka	Anëtar
Tefta Zaka	"

Natasha Sheshi “
Agron Lamaj “
Valentina Kondili “
Petrit Plloci “
Nikoleta Kita “
Vangjel Kosta “
Zamir Poda “
Artan Hoxha “
Vladimir Bineri “
Vladimir Metani “
Ylvi Myrtja “
Perikli Zaharia “

në seancën gjyqësore të datës 15.9.2000 morën në shqyrtim çështjen civile që u përket:

PADITËS: Gjergji Leka, në mungesë.

I PADITUR: Dhimitër Leka, në mungesë.

OBJEKTI: Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv bazuar në nenin 609 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e rrethit gjyqësor Lezhe, me vendimin nr. 730, datë 12.11.1996 ka vendosur:

Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për kontratën e shitblerjes nr.302, datë 11.7.1995 duke detyruar Gjergj Lekën të paguajë në favor të Dhimitër Lekës shumën prej 176.640 lekë. Pas lëshimit të urdhërit të ekzekutimit paditësi Gjergj Leka ka paditur Dhimitër Lekën duke kërkuar pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv.

Gjykata e rrethit gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 231, datë 29.9.1997 ka vendosur:

Pranimin e padisë pjesërisht duke vendosur detyrimin e paditësit Gjergj Leka t’i kthejë të padituri Dhimitër Leka shumën prej 211.968 lekë letra me vlerë dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 648, date 24.3.1998 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit 231, date 29.9.1997 të gjykatës së rrethit Lezhë.

Gjykata e Kasacionit, me vendimin nr.11, datë 21.1.1999 ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr. 648, datë 24.3.1998 të gjykatës së Apelit Tiranë si dhe të vendimit nr.231, datë 29.9.1997 të gjykatës së rrethit Lezhë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e Apelit Shkodër.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.6, date 23.4.1999 ka vendosur:

Rrëzimin e padisë së paditësit Gjergj Leka si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Kundër vendimit të gjykatës së Apelit Shkodër ka paraqitur rekurs paditësi Gjergj Leka duke parashtruar se:

Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë lidhur me zbatimin e nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile, nëse detyrimi ekziston në një masë më të vogël ose është shuar fare.

Kryetari i Gjykatës së Lartë në bazë të nenit 17/1 të ligjit Nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë” u ka paraqitur Kolegjeve të Bashkuara kërkesë për njesimin e praktikës gjyqësore lidhur me përcaktimin e kushteve e rrethanave sipas të cilave nje akt noterial konsiderohet titull ekzekutiv.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Valentina Kondili dhe Agron Lamaj, pasi dëgjuan prokuroren Valentina Ahmetaj, e cila kërkoi që çështja të gjykohet nga Kolegji Civil e jo nga Kolegjet e Bashkuara, sepse, sipas prokurores, që një çështje të gjykohet në Kolegjet e Bashkuara duhet të paraqiten konkretisht të paktën dy praktika të ndryshme të të njëjtit kolegj; e pasi e biseduan

çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë:

Nga materialet e çështjes rezulton si më poshtë:

Me datë 11.7.1995 Dhimitër Leka, me cilësinë e shitësit dhe Gjergj Leka, me cilësinë e blerësit, kanë lidhur para noterit një kontratë shitblerje të një sasie letrash me vlerë nominale 483.300 lekë kundrejt çmimit në lekë baraz me 80 % të kësaj shume, me një afat pagese brenda 5 muajve, d.m.th. deri me datë 31.12.1995.

Duke qenë se gjykata e rrethit gjyqësor Lezhë kontratën noteriale të mësipërme e ka konsideruar titull ekzekutiv dhe ka lëshuar për të një urdhër ekzekutimi, paditësi Gjergj Leka ka ngritur një padi duke kërkuar pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, anullimin e veprimeve përmbarimore dhe detyrimin e të padituritit Dhimitër Leka t'i paguajë shumën prej 181.940 lekë.

Në padi paditësi pretendon se me të padituritn kanë ushtruar një biznes të përbashkët, i cili më vonë ka falimentuar, dhe se, duke bërë llogaritë përkatëse, ai jo vetëm që nuk i detyrohet të padituritt, por ky i fundit i detyrohet në shumën 181.940 lekë.

Të gjitha gjykatat që e kanë gjykuar këtë çështje i janë referuar nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin bazohet padia për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, por, ndërkohë, ato e kanë kaluar në heshtje problemin, nëse kontrata noteriale e shitjes se letrave me vlerë datë 11.7.1995 është apo jo titull ekzekutiv në kuptim të nenit 510, pika "d" të Kodit të Procedurës Civile, ose kanë lënë të nënkuptohet ekzistenca e titullit ekzekutiv, sepse e kanë quajtur të mirëqenë urdhërin e ekzekutimit të kontratës noteriale të shitjes datë 11.7.1995, lëshuar me vendimin nr.730, date 12.11.1996 të gjykatës së rrethit Lezhë.

Duke pasur parasysh përmbajtjen e nenit 510 "pika d" (të pandryshuar) të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit:

"Janë tituj ekzekutivë:

…….

……

d) aktet noteriale që përmbajnë detyrime për pagime në para…..”, në shumë raste gjykata të shkallëve të ndryshme i kanë quajtur tituj ekzekutivë kontratat e huasë të lidhura në formë noteriale. Në rastin në shqyrtim gjykatat e të gjitha shkallëve kanë avancuar akoma më tej duke quajtur titull ekzekutiv edhe një kontrate shitjeje të letrave me vlerë, të lidhur në formë noteriale (me akt të përgatitur e të vërtetuar nga noteri). Të gjitha këto qëndrime e zgjidhje të vërejtura në praktikën gjyqësore të viteve të shkuara janë të gabuara, prandaj Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nëpërmjet këtij vendimi udhëzojnë gjykatat që të mbajnë në të ardhmen një qëndrim të unifikuar dhe të drejtë.

Pretendimi i prokurores, sipas së cilës në rastin konkret nuk ka vend për të marrë një vendim unifikues për praktikën gjyqësore, nuk është i bazuar. Për të marrë një vendim të tillë nuk është e domosdoshme që të prezantohen dy ose më tepër vendime të Kolegjeve të veçanta të Gjykatës së Lartë që kanë dhënë zgjidhje të ndryshme për çështje të ngjashme.

Një vendim unifikues për praktikën gjyqësore mund të merret edhe në raste të tilla, si ky që paraqitet për shqyrtim, kur në të gjitha vendimet e dhëna me parë për çështjen nga gjykatat e të gjitha shkallëve janë bërë interpretime të gabuara të ligjit.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjykojnë se një veprim juridik i dyanshëm (kontratë), qoftë kjo kontratë e dyanëshme siç është p.sh. kontrata e shitjes, qoftë kontrate e njëanëshme, siç është p.sh. kontrata e huasë, nuk mund të jetë titull ekzekutiv.

Tituj ekzekutivë janë kryesisht vendimet gjyqësore, si dhe, në raste përjashtimore, akte te tjera, të parashikuara shprehimisht në Kodin e Procedurës Civile, ose në ligje të veçanta, të cilat, për nga fuqia e tyre ekzekutive barazohen për të gjitha efektet me vendimet gjyqësore të formës së prerë. Që një akt i nxjerrë nga një organ kompetent shtetëror, apo i përgatitur e i vërtetuar nga një nëpunës publik, në kushtet e parashikuara në mënyrë eksplicite në ligj, të jetë titull ekzekutiv, duhet të përmbajë një detyrim të njohur e të përcaktuar saktë, të kërkueshëm, që nuk lidhet me plotësimin e afateve të caktuara, dhe, mbi të gjitha, të pakushtëzuar nga rrethana të tjera apo nga detyrime të tjera të ndërsjellta.

Akti noterial si titull ekzekutiv, duhet të përmbajë në vetvehte një veprim juridik me detyrim

të njëanshem dhe abstrakt për pagimin e një shume të caktuar në para. Gjithashtu detyrimi i kërkueshëm që përmbahët në të. nuk mund të kontestohet për mosekzistencë të tij në kohën e hartimit e të nënshkrimit të aktit, dhe as lind nevoja që të provohet. Ai prezumohet i vërtetë.

Akti për pagimin e një shume në para, i hartuar në formën e një deklarate noteriale, duke qenë titull ekzekutiv, mund të goditet vetëm për falsitet ose të kundërshtohet vetëm për shkaqet e parashikuara në nenin 609/1 te Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj dispozite, "Debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm, ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël, ose është shuar më pas".

Akti noterial për pagimin e një shume në para, si titull ekzekutiv ngjason për nga përmbajtja e tij me një kambial, por ndryshon prej tij sepse nuk e ka cilësinë e një letre me vlerë dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përdoret e të tregtohet si e tillë.

Akti noterial si titull ekzekutiv mund të përmbajë edhe një detyrim që buron nga një kontratë e mëparshme, apo, më gjerë, nga çdo veprim juridik tjetër i mëparshëm, ku debitori ka qenë palë. Ky detyrim i ri, që jo rrallë shuan detyrime të mëparshme, pasi merret përsipër nga debitori në mënyrë të njëanëshme e pa kushte, fiton një ekzistencë të mëvetësishme e të pavarur.

Nisur nga qëndrimet e ndryshme të praktikës, ligjvënësi më vonë e ka ndryshuar formulimin e nenit 510, pika "d" të Kodit të Procedurës Civile, si më poshtë:

"Jane tituj ekzekutivë:

……..

d) Aktet noteriale me të cilat autorizohet shlyerja e një detyrimi kontraktual, ose e çdo detyrimi tjetër të mëparshëm, drejtperdrejt nga depozitat bankare ose nga paga e autorizuesit dhe në kreditë e tij tek të tretët…".

Theksojmë se ligjvënësi në këtë formulim te ri, në thelb nuk ka ndryshuar asgjë, veçse, në funksion të zbatimit e interpretimit të saktë të kësaj dispozite, sipas kuptimit të natyrshëm të saj, të bazuar në arsyen (ratio legis) ka bërë një paraqitje më analitike, më të qartë dhe më të plotë të saj.

Theksojmë se burimet e tërheqjes së shumës së parave që përmbahet në aktin noterial me cilësinë e titullit ekzekutiv, tregohen në mënyrë indikative dhe jo shteruese. Organi që bën ekzekutimin e titullit ekzekutiv, në mungëse të tyre, nuk mund të ndalohet që shumën në fjalë ta nxjerrë edhe nga burime të tjera pasurore të debitorit. E kundërta do të ishte e papranueshme, sepse do të binte ndesh me rregullat dhe parimet e pergjithshme të ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë.

Lidhur me pretendimin e ngritur në rekurs, sipas të cilit gjykata e Apelit Shkodër nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë lidhur me zbatimin e nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile, nëse detyrimi ekziston në një masë më të vogël ose është shuar fare, Kolegjet e Bashkuara janë të mendimit se para se të shtroheshin këto probleme duhej zgjidhur paraprakisht problemi nëse në rastin konkret ndodheshim apo jo përpara një titulli ekzekutiv. Për shkaqet që analizojmë më lart kontrata e shitjes së letrave me vlerë, ashtu si dhe çdo kontratë tjetër, pavarësisht se mund të jetë bërë në formë noteriale, nuk është dhe nuk mund të jetë titull ekzekutiv.

Vendimi nr.6 datë 23.4.1999 i gjykatës së Apelit Shkodër i atakuar me rekurs është marrë në kundërshtim me ligjin, sepse kontrata noteriale e shitjes së letrave me vlerë dhe çdo detyrim tjetër që, për çfarçdo lloj shkaku, mund të ketë lindur midis palëve, nuk përbën titull ekzekutiv, prandaj urdhëri i ekzekutimit i lëshuar nga gjykata nuk ka objekt ekzekutimi.

Duke qenë kështu, gjersa paditësi në padinë e tij i referohet edhe nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, gjykata ishte e detyruar të merrte në shqyrtim dhe të vendoste nëse veprimet e ekzekutimit të përmbaruesit gjyqësor i konsideronte apo jo të ligjshme.

Kolegjet e Bashkuara gjykojnë që ato s`mund të jenë të ligjshme gjersa urdhërojnë ekzekutimin e detyrueshëm të një akti që nuk është titull ekzekutiv.

Duke e konsideruar titullin ekzekutiv të paqenë, rrjedhimisht veprimet përmbarimore të kryera për ekzekutimin e tij duhet të anullohen dhe ekzekutimi duhet të pushohet, sipas kërkesës së nenit 616, pika "ç", të Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj dispozite, "Ekzekutimi pushon :

……

ç) kur me vendim të gjykatës që ka marrë formën e prerë, është pranuar padia e debitorit sipas nenit 610 të këtij Kodi,…..…".

Zgjidhja e konflikteve që mund të kenë palët me njëra-tjetrën, si ato që lidhen me detyrimet e marra përsipër me kontratën e shitjes së letrave me vlerë, ashtu dhe ato që mund të kenë për detyrime të tjera të ndërsjellta midis tyre, mund të realizohet vetëm në rrugën e zakonshme duke paraqitur në gjykatë padi themeli. Edhe kërkimi i paditësit Gjergj Leka për t'u detyruar ndaj tij i padituri Dhimitër Leka në shumën prej 133.360 lekë mund të zgjidhet vetëm në kuadrin e gjykimit të një padie themeli, ose në formë kundërpadie të paraqitur në një gjykim të filluar. Referenca në rregullat e përgjithshme për detyrimet monetare të parashikuara në nenet 445 e 450 të Kodit Civil, nuk përcakton shkakun e ndonjë padie konkrete që mund të ngrihet prej tij. Për më tepër një kërkim i tillë monetar nuk mund të ngrihet së bashku me padinë e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv (neni 609 i Kodit të Procedurës Civile) dhe me padine e kundërshtimit të veprimeve të përmbarimit (neni 610 i Kodit të Procedurës Civile). Të dy këto gjykime të bazuara në dispozitat proceduriale të sipërpërmendura jane gjykime të posaçme dhe, si të tilla, nuk mund të bashkohen me gjykimin e një padie themeli, siç është edhe kërkimi i shumës prej 133.360 lekë prej paditësit Gjergj Leka.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 485, pika "d" dhe "e", të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S Ë N:

Ndryshimin e vendimit nr.6, datë 23.4.1999 të gjykatës së Apelit Shkodër si më poshtë:

1. Pranimin e padisë së paditësit Gjergji Leka duke e konsideruar titullin ekzekutiv të konceptuar në kontratën noteriale të shitblerjes nr.302, date 11.7.1995 të paqënë, dhe anullimin e veprimeve përmbarimore të kryera në zbatim te tij.
2. Ky vendim për njehsimin e praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, me 29.9.2000
Nr. 1714/437 i Regj. Themeltar.
Nr. 980 i Vendimit.

UDHËZIM
Nr.1, datë 5.10.2000

PËR KRITERET TEKNIKE TË PËRLLOGARITJES SË VLERËS SË BIMEVE DRUFRUTORE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NË RASTET KUR MUNGOJNË TREGUESIT E DEKLARUAR TË SHITBLERJES.

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 " Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe të V.K.M nr.138, datë 23. 3. 2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive prone private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit

U D H Ë Z O N :

A. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i kritereve teknike të përllogaritjes së vlerës së bimëve drufrutore që ndodhen të mbjella në trojet, tokat bujqësore, livadhet etj., ku kryhet shpronësimi i përhershëm ose dhe i përkohshëm për interes publik. Me bimë drufrutore kuptojmë pemët frutore, ullinjtë, agrumet, vreshtat, pjergullat dhe ereket si dhe fidanishtet e prodhimit të materialeve mbjellëse të tyre.

Sipas destinimit, bimët drufrutore janë :

a- Bimët drufrutore që kultivohen për prodhimin e frutave të tyre.

b- Bimët drufrutore "mëmë" që kultivohen për të marrë materiale shumëzimi për shtimin e tyre.

c- Bimë drufrutore me vlerë gjenetike e të regjistruara si të tilla në Bankën Gjenetike pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve ose dhe në Institutin e Pemëtarisë.

ç- Bimë drufrutore që kultivohen me qëllim prodhimin e frutave të tyre dhe për rregullimin e mjedisit banues ose dhe të mjedisit të aktivitetit të biznesit.

d- Fidanishtet me të gjitha strukturat e prodhimit të materialeve të shumëzimit e të materialeve mbjellëse të bimeve drufrutore.

Kriteret teknike që përcaktohen në këtë udhëzim për përllogaritjen e vlerës së bimëve drufrutore dhe të masës së shpërblimit, shërbejnë për rastet kur mungojnë treguesit e shitblerjeve të deklaruara nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)

B. Përllogaritja e vlerës së bimëve drufrutore bëhet me metodën e kostos së investimeve dhe shpenzimeve ushtrimore të kryera në fakt, duke marrë për bazë vlerat e punës së gjallë, mekanikës dhe bazës materiale, që janë në momentin e vlerësimit.

Procedura që duhet ndjekur për përcaktimin e vlerës së bimëve drufrutore.

I. Për pemët frutore, ullinjtë, agrumet, vreshtat, pjergullat dhe ereket.

Në fillim, për çdo specie bimore, përcaktohen në vend këto të dhëna :

- Emri e mbiemri i pronarit
- Emërtimi i species
- Numri i rrënjëve
- Mosha në vite
- Sipërfaqja e tokës që zihet nga bima ose bimët m2
- Faza e zhvillimit vjetor të bimës ose të bimëve në momentin e prishjes
- Gjendja e prodhimit në bimë që nuk ka vlerë përdorimi ose dhe i ulët vlera në momentin e prishjes
- Amortizimi shëndetësor i vlerësuar në përqindje
- Lëndë drusore që ka vlerë përdorimi në metër stere(ms)
- Të dhëna të tjera (Numri i bimëve që janë të regjistruara në Bankën Gjenetike, numri i bimëve që shërbejnë si bimë "mëmë", numri i bimëve që ndodhen në territorin e mjedisit banues ose të objekteve të biznesit kur banesa ose dhe objektet e biznesit nuk i zë shpronësimi e prishja. Për vreshtat që vlerësohen me sipërfaqe përcaktohet dhe përqindja e boshllëqeve në numrin e bimëve).

Pas plotësimit të të dhënave të sipërshkruara përllogoritet vlera si më poshtë:

1.Vlera në periudhën e rritjes (V.1)

a-Investimet e mbjelljes (Punë +Mekanikë+Bazë materiale etj.)

b-Investime të tjera që u shërbejne bimëve si sistem kullimi, ujitje, mbështetje, mbulimi etj.

c- Investimet për shërbimet vjetore të rritjes.

ç- Efekti ekonomik nga mos shfrytëzimi i tokës për aq vite sa bimët drufrutore kanë kaluar periudhën e rritjes (Fitimi neto që merret nga pjelloria e tokës që është zënë nga bima, apo bimët drufrutore)

Për rastet, kur bima ose bimët janë në moshë rritje, investimet për shërbimet në rritje dhe efekti ekonomik nga mosshfrytëzimi i tokës (c dhe ç) llogariten për aq vite sa është mosha e bimës në rritje në vendin e përhershëm.

Pra : V1 = a + b + c + ç

2-Vlera e prodhimit të pritshëm (V.2) që vleresohet gjendje ne peme dhe qe nuk ka vlere perdorimi (V.2=sasi x çmimi per njesi – vlerën e shpenzimeve te mbetura), Çmimi për njësi merret çmimi i realizur një vit më parë në portën e fermës.Për rastet kur prodhimi ne momentin e prishjes ka nje vlere perdorimi por kjo vlere është me e ulet se sa vlera ne pjekjen e vjeljes, V2 = sasi x diferncen e çmimit per njesi.

3-Vlera te tjera (V.3), qe shtohen sipas rastit (V3)

a- Në rastet kur bima ose bimët drufrutore shërbejnë si bimë mëmë për të marrë material të zgjedhur shumëzimi për nevojat e vetë pronarit, ose për t'i shitur tek të tjerët, shtohet 20 % e (V.1 – V.4.a ose V. 4.b)

b- Në rastet kur bima ose bimët drufrutore që shpronësohen (prishen) janë të regjistruara ne bankën gjenetike(të vërtetuara me dokument të lëshuar nga institucioni përkatës) te Institutit te Pemtarise apo te Bankes Gjenetike te Entit Shteteror te Farave e Fidanave, iu shtohet 50 % e (V.1 – V.4.a ose V.4.b)

c- Ne rastet kur bimet dru frutore qe shpronesohen ndodhen ne territorin e truallit te baneses apo qendres se nje aktiviteti biznesi qe nuk prishet e nuk shpronesohet, vleres se bimeve i u shtohet 30 % per efekt te prishjes se mjedisit baneses apo te biznesit. Pra shtohet 30 % e (V.1 – V.4.a ose V.4.b)

Pra : V3 = a + b + c

4-Vlera qe bëhen zbritje (V.4).

a- Amortizimi shendetesor (nga dëmtues e sëmundje, nga mungesa e shërbimeve, nga demtime fizike, nga mosha etj.) i cili vleresohet ne vend dhe shprehet ne perqindje ndaj V.1 dhe ne vlere.

b- Për rastet kur bima ne pamje nuk duket e amortizuar nga ana shendetesore, atehere zbritet perqindja e amortizimit sipas pasqyres nr.1.duke filluar nga viti i pare i hyrjes ne prodhim dhe vit pas viti deri ne momentin qe po vleresohet per shpronesim e shprehet ne % ndaj (V.1-V.1.ç) dhe ne vlere.

c- Për vreshtat vleresimi behet me siperfaqe dhe jo me rrënjë, por per rastet kur ka mungesa te numrit te bimeve per cdo 1% mungesa, zbritet 1% e V.1.

ç- Për rastet kur per mirerritjen e bimeve drufrutore është investuar baze materiale

(si sistemi mbeshtetes, impjante ujitese e materiale te ndryshme),qe ka vlere perdorimi edhe pas prishjes, zbritet vlefta e përcaktuar nga komisioni i ekspertëve i ngritur nga investitori.

d- Për rastet kur druri i bimës apo bimëve drufrutore ka vlerë përdorimi per djegie apo per mobileri etj. zbritet vlera e lendes drusore e gatshme minus punen qe ben vete pronari per ta zhvendosur dhe pergatitur ate.

Pra : V.4 = a + b + c + ç + d

Përfundimi: Vlera e mbetur (VM) e llogaritur për shpërblim del si më poshtë:

VM = V1 + V2 +V3 – V4

II. Për luleshtrydhen (hyn në prodhim që në vitin e parë, prodhon 3 vjet)

1- Vlera e investimeve gjithsej (V.1)

V.1 = (a + b) : 3 vjet x nr.viteve bujqësore të mbetura.

Ku:

a- Investimet e mbjelljes.(Punë + mekanikë + bazë materiale)

b- Investime të tjera që i shërbejnë teknologjisë së kultivimit të luleshtrydhes.

(sistem kullimi, ujitje, mbulimi etj.)

2-Vlera e prodhimit të pritshëm (V.2)

Vlerësohet gjendja e prodhimit të pritshëm që nuk ka vlerë përdorimi në momentin e prishjes.Vlera llogaritet me çmimin e ditës ose të një viti më parë në "portën" e fermës minus shpenzimet e vjeljes dhe marketingut. V2 =sasi x çmim për njësi – shpenzimet e mbetura (për shërbime, për vjelje dhe marketing)

3-Vlera që bëhen zbritje (V.3) është vlera e materialeve (konstruksioneve etj.) që kane vlerë përdorimi, e përcaktuar nga komisioni.

Përfundimi: Vlera e mbetur (VM) e llogaritur për shpërblim është :

VM = V.1 + V.2 – V.3

III. Për fidanishtet (farishtet, filizat, kamzat, copat etj), materialet e shumëzimit dhe materialet mbjellëse (fidanet 1- 4 vjecare).

1- Vlera e investimeve fillestare (V.1)

a- Vlera e investimeve për sistemin e parcelimin e tokës (rrugë, kanale, drenazhe).

b- Vlera e investimeve të mbjelljes (puna, mekanika dhe baza materiale).

c- Vlera e investimeve ndihmëse që i shërbejne teknologjisë së prodhimit të fidaneve.

Pra : V1 = a + b + c

2-Vlera e shpenzimeve për shërbimet bujqësore (punë, mekanikë, materiale) të kryera deri në momentin që do të shpronësohen. (V.2.)

3-Vlera materialeve të shumëzimit e të mbjelljes që prishen në vitin kur duhet të shkulen e të tregëtohen, por që nuk kanë vlerë përdorimi e shitje për arsye të kohës së prishjes (V.3)

V.3 = Sasia e pritshme x çmimin e nje viti më parë në "portën" e fermës – (minus) shpenzimet e mbetura (për shërbimet, për shkuljen dhe marketingun).

Përfundimi: Vlera e mbetur(VM) e llogaritur për shpërblim është:

- Për rastet që shpronësimi bëhet në vitin që materialet e shumëzimit ose dhe materialet mbjellëse pritet të tregetohen, vlera e mbetur llogaritet :

VM = V.1 – V.1.b + V.3 – Vmp

Ku: Vmp = vlera e bazës materiale që është e përdorshme përcaktuar nga komisioni.

- Për rastet kur materialet e shumëzimit ose / dhe materialet e mbjelljes nuk kane vlerë tregëtimi në atë vit që bëhet shpronësimi, vlera e mbetur llogaritet:

$$VM = V.1 + V.2 + \{ [(V.1 + V.2) \times 25] \times n \} - Vmp$$
$$100$$

Ku : 25 = 25 % fitimi i munguar.

" n" = numri i viteve nga mbjellja deri në momentin e shpronësimit.

Shembull ilustrues:

Do të shpronësohen pjeshkë.

- Pronari Pëllumb Zylfo Hyseni
- Emërtimi i species pjeshkë
- Nr. i rrënjëve 10
- Mosha: 10 vjecare
- Sipërfaqja që zënë: 200 m2
- Faza e zhvillimit vjetor: në lulëzim
- Amortizimi shëndetësor i vlerësur në vend: 4 rrënjë=30%,6 rrënjë=10 %.
- Lëndë druri: 1 ms (metër stere) për djegie.
- Të dhëna të tjera: 6 rrënjë(me 10 % am. shënd.) shërbejnë si bimë mëmë për të marrë kalema për mbishartesa (të vërtetuara nga inspektori i Farave dhe Fidanave) dhe 3 rrënjë nga këto janë të mbjella në territorin e banesës.

Vlera për shpërblimin e pronarit përcaktohet si më poshtë:

1.V1.

a=1000 lekë/rrënjë x 10 rrënjë=10000 lekë

b= 0 (s'ka)

c= 300 lekë/rrënjë në vit x 10 rrënjë=3000 lekë x 3 vjet në rritje= 9000 lekë

ç= 2000 lekë në vit për 200 m2 x 3 vjet në rritje= 6000 lekë

V.1 = a + b + c + ç

V1= 10000+0+9000+6000=25000 lekë (V1 për rrënjë=2500 lekë).

2. V2 Prodhimi i pritshëm u vlerësua gjithsej :

V2=500 kg. fruta x 30 lek/kg=15000 lekë-3000 lekë (shpenzime të mbetura)=12000 lekë

3. V3 = a + b + c

a – janë 6 rrënjë bimë mëmë që ju shtohet a =(V1-V4.a)x 20%.

V1 për 6 rrënjë = 15000 lekë, V4. a= 10% e V1 = 1500 lekë a =(15000 - 1500) x 20%=13500 x 20 = 2700 lek

100

b - nuk ka

c = 3 rrënjë mëmë në mjediset e banesës = (V1-V4.a)x30%. V1 për 3 rrënjë=7500 lekë, V4.a = 10% e V1=750 lekë. Pra c =(7500-750)x30%=6750 x 30 = 2000 lekë.

100

V.3 = 2700 + 0 + 2000 = 4700 lekë

4. V4= a + b + c + ç + d

a = 30% e V1 te 4 rrënjëve+ 10% e V1 të 6 rrënjëve = 10000 x 30 + 15000 x 10 = 3000 + 1500= 4500 lekë

100 100

b = nuk ka

c = nuk ka

ç = nuk ka

d = Sipas vlerësimit të 10 rrënjëve pjeshke japin 1 ms (metër stere) dru zjarri me vlerë në vend 1000 lek – 300 lekë vlerë pune= 700 lekë.

V4 = 4500 + 0 + 0 + 0 + 700 = 5200 lekë.

Përfundimi : Vlera e mbetur për shpërblim VM rezulton si më poshtë:

VM = V1+V2+V3-V4= 25000+12000+4700-5200=36500 lekë.

Pra vlera e llogaritur për shpërblimin e pronarit të 10 rrënjë pjeshkëve të përshkruara si më sipër për shpronësim, është 36 500 lekë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Lufter Xhuveli

PASQYRA NR.1
DISA TË DHËNA ORIENTUESE PËR BIMËT DRUFRUTORE

Nr.	Emërtimi	Jetëgjatësia		Vitit i hyrjes në prodhim	Sip. e përafërt e tokës që zë një bimë kur është e vetmuar m2	Amortizimi vjetor sipas V.K.M. nr.401, dat.23.10.1989 në %
		Gjithsej vjet	Nga këto Në rritje vjet			
I.	**PEMË FRUTORE**					
1.	Mollë mbi mollcinë	60	8	9	50	2
2.	Mollë mbi nënshartesë vegjetative	20	5	6	10	2
3.	Dardhë mbi nënshartesë të egër	50	8	8	50	2
4.	Dardhë mbi nënsh.Vegjetative	20	5	6	10	2
5.	Ftua	35	4	5	20	2
6.	Kumbull	35	5	6	40	2
7.	Qershi	40	6	7	50	2
8.	Vishnje	35	5	6	40	2

9.	Pjeshkë	15	3	4	20	2
10.	Kajsi	30	5	6	30	2
11.	Fik	60	5	6	40	2
12.	Hurma (kaki)	35	4	5	30	2
13.	Mushmollë dimërore	30	4	5	40	2
14.	Nespola(mushmollë verore)	30	5	6	30	2
15.	Shegë	30	5	6	30	2
16.	Hide (xinxife)	40	7	8	30	2
17.	Mana për fruta	80	6	7	50	2
18.	Gështenja	80	8	9	60	2
19.	Arra	100	10	11	60	2
20	Bajame	35	6	7	40	2
21.	Lajthi	40	4	5	20	2
22.	Vodhëz	80	8	9	30	2
23.	Thana	35	7	8	30	2
24.	Luleshtrydhe	3	-	1	-	-
25.	Aktinidje (Kivi)	30	4	5	5	2
II.	**AGRUME**					
1.	Portokall	40	5	6	30	2
2.	Mandarine	40	5	6	30	2
3.	Limon	40	5	6	30	2
4.	Të tjera agrume	40	5	6	30	2
III.	**ULLINJ**					0.5
1.	Ullinj të mbjellë 16-200 rrënjë/ha	150	9	10	60	0.5
2.	Ullinj të mbjellë mbi 400 rrënjë/ha	150	6	7	30	0.5
IV.	**VRESHTARIA**			4		
1.	Vreshta për rrush	40	3	4	-	2.5
2.	Vreshta antifilokserik	30	3	5	-	2.5
3.	Pjergulla	50	4	5	20	2.5
4.	Ereke	50	4		5	2.5

Shënim: Për drufrutorët e mbjella në distanca të rregullta në ngastra ose blloqe, sipërfaqja që zë çdo bimë varet nga skema e mbjelljes (distanca mes rreshtave dhe në rresht)

Përmbledhëse e vlerësimit të bimëve frutore që shpronësohen për interes publik dhe masa e shpërblimit të pronarit të tyre

Pronari_____ Adresa_____ Objekti_____
(emri, mbiemri) (fshati ose qyteti, komuna ose bashkia) (emërtimi i objektit që bën të domosdoshëm shpronësimin)

Dokumenti që vërteton pronësinë_____, Adresa e vendndodhjes së pronës_____
(emri i dokumentit dhe nr. i tij) (fshati ose qyteti, komuna ose bashkia dhe kufizimet)

Nr.	Emërtimi i drufrutorëve që shpronësohen (sipas moshave)	Vlerësimi i gjendjes në vend													Vlera për shpërblim lekë
		Rrënjë Gjithsej	Sip e zënë m^2	Faza e zhvill.	Vlerës. Prodh.	Amort.Shëndet.%			Lëndë druri e përdor.			Të dhëna të tjera			
						%	%	%							

_____, më____/___/_____. Pronari Vlerësuesit e Autorizuar
(fshati ose qyteti) (data) _____ _____

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 28.10.2000
Doli nga shtypi më 31.10.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Çmimi: 150 lekë